



OPEN SOCIETY INSTITUTE
EU MONITORING AND ADVOCACY PROGRAM

MEDIA PROGRAM

Televizioni në Europë:

Raportet Vijuese 2008

SHQIPËRIA

Botuar nga

OPEN SOCIETY INSTITUTE

Október 6. u. 12.
H-1051 Budapest
Hungary

400 West 59th Street
New York, NY 10019
USA

© OSI/EU Monitoring and Advocacy Program, 2008

Të drejta të rezervuara.



TM dhe Copyright © 2008 Instituti i Shoqërisë së Hapur

EU MONITORING AND ADVOCACY PROGRAM

Október 6. u. 12.
H-1051 Budapest
Hungary

Website
<www.eumap.org>
<www.mediapolicy.org>

Design & Layout: Instituti Shqiptar i Medias

Falenderime

Ky raport u përgatit si pjesë e një sërë raportesh monitoruese me titullin ‘Televizioni në Europë: Raportet Vijuete 2008’. Kjo seri paraqet një rifreskim të gjendjes në nëntë nga njëzet vendet e origjinës të mbuluara në serinë e raporteve të 2005 “Televizioni në Europë: rregullimi, politikat dhe pavarësia”. Vendet e përfshira në serinë e vitit 2008 janë: Shqipëria, Bullgaria, Republika Çeke, Italia, Lituania, Maqedonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia.

Të dyja seritë e raporteve janë përgatitur nga Programi për Monitorim dhe Avokaci të BE(EUMAP) i Institutit të Shoqërisë së Hapur dhe nga Media Program i Fondacionit për Shoqëri të Hapur, në bashkëpunim me ekspertët vendas. EUMAP dhe Media Program do të donin të falenderonin personat e mëposhtëm, të cilët patën rol kryesor në kërkimet dhe hartimin për raportin e këtij vendi.

Përgjegjësia përfundimtare për përmbajtjen e raporteve i mbetet Programit.

“Televizioni në Europë – Raportet Vijuete 2008, Shqipëria”

Redaktorët

Marius Dragomir (Media Program)

Menaxher Projekti dhe Redaktor

Mark Thompson (Media Program)

Redaktor

Reporter për vendin

Ilda Londo

Instituti Shqiptar i Medias

Ekipi OSI

Gordana Janković (Media Program)

Drejtoresha Programi

Biljana Tatomir (Media Program)

Zëvendës Drejtoresha

Miriam Anati (EUMAP)

Avokacia dhe Komunikimi

Andrea Gurubi Watterson (EUMAP)

Koordinatorja Programi

Csilla Tóth (EUMAP)

Asistente Programi

Joost van Beek (EUMAP)

Manaxher i website

Sergey Shabanov (EUMAP)

Ndërtues i website

Hyrje

Televizioni në Europë: Raportet Vijuese 2008 është një projekt monitorimi i EUMAP (Programi i për Monitorim dhe Avokaci të BE) në Institutin për Shoqëri të Hapur dhe i Media Program në Fondacionin për Shoqëri të Hapur. Projekti freskon dhe bazohet mbi përfundimet e raporteve origjinale të monitorimit *Televizioni në Europë: rregullimi, politikat dhe pavarësia*, të lançuara në tetor 2005, të cilat kanë mbuluar 20 vende.

Raportet e vitit 2005 arritën në përfundimin se roli i rëndësishëm i televizionit në mbështetje të demokracisë në Europë ishte i kërcënuar. Raporti tregoi se transmetuesit publikë po detyroheshin të cënonin cilësinë për të konkurruar me kanalet private dhe se shumë prej tyre vareshin nga shteti apo partitë politike. Për më tepër, përqendrimet gjithnjë e më të mëdha po krijoheshin në sektorin privat, shpesh me lidhje të qarta politike. Këto zhvillime vinin në rrezik pluralizmin dhe diversitetin e transmetimeve, sidomos në demokracitë e reja të Europës Qendrore dhe Lindore.

Projekti fillestar *Televizioni në Europë* dhe veprimtaritë e tij në avokaci përfunduan në qershor 2006. Që atëherë, Media Program ka financuar një numër projektesh pasuese, të zhvilluara nga organizata partnere në vendet në fjalë, të cilat kishin për qëllim të promovojnë dhe të bazohen në rezultatet dhe përfundimet e raporteve.

Në shumë nga vendet e pasqyruara në raportet e 2005 ka pasur zhvillime të rëndësishme në shumë nga fushat e monitoruara. I lançuar në Londër në mars 2008, *Televizioni në Europë: Raportet Vijuese 2008* monitoron këto zhvillime në nëntë nga njëzet vendet që u monitoruan në fillim: Shqipëria, Bullgaria, Republika Çeke, Italia, Lituania, Maqedonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia. Këto vende u zgjodhën për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme dhe të rëndësishme në peizazhin e tyre të transmetimeve.

Televizioni në Europë: Raportet Vijuese 2008 skicon ndryshimet kryesore në legjislacionin, politikat dhe tregun e transmetimeve gjatë tre viteve të fundit dhe vlerëson progresin – ose mungesën e progresit – që këto vende kanë pasur në përmirësimin e pavarësisë dhe pluralizmit të transmetimeve.

Ashtu si me raportet fillestare të vitit 2005, këto raporte vijuese u drejtohen politikëbërësve, aktivistëve të shoqërisë civile dhe akademikëve, si një kontribut për të sjellë ndryshime atje ku ka nevojë.

Nëntë raportet e këtyre vendeve u hartuan nga ekspertë vendas me mbështetjen e OJQ-ve partnere. Të gjitha raportet janë bazuar në të njëjtën metodologji, duke krijuar mundësi për një analizë krahasuese. OSI dhe OSF mbajnë përgjegjësinë përfundimtare për përmbajtjen e tyre.

Mbi EUMAP

EUMAP, Programi i për Monitorim dhe Avokaci të BE i Institutit për një Shoqëri të Hapur, monitoron zhvillimin e disa çështjeve të të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor si në Bashkimin Europian, ashtu edhe në vendet kandidatë apo ato kandidatë të mundshme.

EUMAP punon me ekspertë vendas dhe me organizata joqeveritare (OJQ) për të hartuar raporte që shpërndahen gjerësisht në Europë dhe më tej. Raportet kanë për qëllim që të nxisin pjesëmarrje më të gjerë në procesin e artikullimit të vlerave të përbashkëta demokratike të BE si dhe monitorimin e vazhdueshëm të respektit për standartet e të drejtave të njeriut në Bashkimin Europian.

Përveç këtyre raporteve monitorimi për Televizionin në Europë, EUMAP është përqendruar edhe në mundësitë e romëve për arsim dhe në gjendjen e myslimanëve në qytetet e përzgjedhura të BE.

Raporte të mëparshme të EUMAP përfshijnë serinë e 2005 Televizioni në Europë, si edhe raporte për mbrojtjen e pakicave, të drejtat e njerëzve me intelekt të kufizuar, pavarësinë e gjyqësorit, kapacitetin e gjyqësorit, korrupsioni dhe politikën antikorrupsion dhe mundësitë e barabarta për femra dhe meshkuj.

Të gjitha raportet e EUMAP si dhe informacion i mëtejshëm për programin gjendet në www.eumap.org.

Mbi Media Program

Media Program përqipet të nxisë median e pavarur, profesionale dhe të qëndrueshme si dhe gazetarinë cilësore, kryesisht në vende që po kalojnë një proces demokratizimi dhe po ndërtojnë tregje funksionale të medias.

Media Program mbështet nisma që kanë për qëllim të ndihmojnë legjislacionin për median që të jetë konform standarteve demokratike ndërkombëtare, duke rritur profesionalizmin e gazetarëve dhe drejtuesve të medias, duke forcuar shoqatat e profesionistëve të medias dhe duke krijuar mekanizma të vetërregullimit në media. Media Program gjithashtu mbështet ato media që përkrahin vlerat e një shoqërie të hapur, si dhe përpjekjet që kanë për qëllim të monitorojnë dhe kundërshtojnë shkeljet e lirisë së shtypit dhe që nxisin ndryshime të politikës së medias që sigurojnë pluralizmin e pronësisë së medias dhe diversitetin e mendimit në media.

Edhe pse tradicionalisht Media Program është përqendruar në Europën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, CIS, dhe Mongoli, gjatë viteve të fundit ajo është zgjeruar në Afrikën Perëndimore dhe Jugore, në Azinë Juglindore dhe në Amerikën Latine.

Televizioni në Europë:

Raportet vijuese 2008

Shqipëria

nga Ilda Londo

Përmbajtja

A. Përmbledhja e përgjithshme.....	10
B. Rekomandimet	11
1. Rekomandimet fillestare nga raporti i 2005	11
1.1 Politikat	12
1.2 Autoritetet rregullatore (KKRT)	14
1.3 Transmetuesit publikë dhe privatë	15
1.4 Transmetuesi publik (RTSH)	17
1.5 Shoqëria civile	18
2. Rekomandimet e reja sipas raportit të vitit 2008	18
2.1 Legjislacioni	18
C. Përfundimet kryesore të monitorimit vijues	19
1. Ambienti i përgjithshëm i transmetimeve	19
1.1 Zhvillimet kyçe në legjislacion dhe politika	19
1.2 Masat ligjore të BE	19
1.3 Tregu i transmetimeve	20
2. Rregullimi dhe licensimi i sektorit të televizionit	21
2.1 Autoritetet dhe korniza rregullatore	21
2.2 Sistemi i licensimit.....	24
3. Rregullimi dhe menaxhimi i transmetuesit televiziv të shërbimit publik	28
3.1 Legjislacioni dhe politikat për transmetuesin publik	28
3.2 Struktura qeverisëse e transmetuesit publik	28
3.3 Financimi i transmetuesit publik	31
3.4 Standartet editoriale	32
4. Transmetuesit privatë	34
4.1 Rregullimi dhe menaxhimi	34
4.2 Pronësia e televizioneve dhe pronësia e ndërthurur	34
4.3 Tregu i reklamave	34
4.4 Standartet dhe pavarësia editoriale	37

4.5 Transmetuesit rajonalë dhe lokalë	38
5. Programacioni	39
5.1 Programet	39
5.2 Rregullat e përgjithshme për lajmet	40
5.3 Udhëzimet e përgjithshme për prodhimin e programeve	41
5.4 Kuotat	42
5.5 Detyrimet për transmetuesin publik	42
5.6 Detyrimet për transmetuesit privatë	43
6. Përfundimet	43
ANEKS 1. Legjislacioni i përmendur në raport	45
ANEKS 2. Bibliografia	46

Lista e shkurtimeve

EBU *Unioni i Transmetuesve Europeanë*

KESH *Korporata Elektroenergjitike Shqiptare*

KKRT *Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit*

KLSH *Kontrolli i Lartë i Shtetit*

OSCE *Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë*

RRC-06 *Konferenca Rajonale e Radio-komunikacioneve në Gjenevë 2006*

RT *Radio Tirana*

RTSH *Radio Televizioni Shqiptar*

TVSH *Televizioni Shqiptar*

WAZ *Westdeutsche Allgemeine Zeitung*

A. Përmbledhja e përgjithshme

Media elektronike përbën sektorin më të rëndësishëm në tregun e medias shqiptare. Megjithë zhvillimin e vazhdueshëm profesional, media elektronike është ende pre e dyshimeve për burimet e financimit dhe ecurisë së saj ekonomike. Mediat elektronike vazhdojnë të mbeten të paqëndrueshme ekonomikisht dhe të varen kryesisht për të ardhurat e tyre nga bizneset e tjera të pronarëve. Kjo situatë hedh dyshime serioze mbi pavarësinë e tyre editoriale dhe mbi cilësinë e informacionit që i ofrohet publikut. Qeveria është përpjekur ta zgjidhë çështjen e diskutueshme të caktimit të reklamave shtetërore, por ende nuk është e qartë nëse janë çrrënjësor praktikatat e mëparshme. Qeveria vendosi të botonte reklamat shtetërore vetëm në buletin zyrtar për ta shkëputur median nga varësia e saj nga qeveria. Por ligji nuk e përcakton qartë reklamën shtetërore, duke krijuar mundësi për mbështetje arbitrare.

Qeveria gjithashtu ka filluar një sërë amendimesh ligjore të diskutueshme në lidhje me rregullatorët dhe transmetimet numerike. Qeveria pretendoi se këto përpjekje kishin për qëllim të përmirësonin pavarësinë e medias, por kritikët lanë të kuptohej se arsyeja kryesore ishte të vihehin nën kontroll rregullatorët dhe t'i mbyllej goja medias së pavarur. Mungesa e debatit dhe këshillimit publik me palët e interesuara gjatë përgatitjes së ndryshimeve ligjore i forcoi akoma më shumë këto dyshime.

Megjithëse po kalon një reformë domethënëse, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) nuk ka bërë përpjekje të mëdha në përbushjen e misionit të tij. Vendimet e tij për të dhënë licensa transmetimi dhe për të hequr antena janë kundërshtuar. Dhënia e licensave numerike në të ardhmen e afërt do të jetë testi përfundimtar për autoritetin dhe pavarësinë e KKRT. Televizioni numerik ka bërë përpjekje të rëndësishme që nga lindja e tij në një zbrazëti ligjore tre vjet më vonë. Popullariteti i tij është gjithnjë në rritje.

Zbatimi i duhur i ligjit nevojitet sidomos për fuqizimin e rolit të transmetuesit publik, *Radio Televizionit Shqiptar* (RTSH), si dhe për të krijuar mundësinë që ai të përbushë misionin e vet. Roli i transmetuesit publik ka ardhur në zbehje, ndërsa stacionet televizive private kanë investuar vazhdimisht në punën e tyre. Reforma e RTSH ka mbetur në vend; akuzat që ai favorizon qeverinë kanë vazhduar. Drejtuesit aktualë më në fund kanë përpiluar një strategji për ta transformuar institucionin në një transmetues publik efikas. Megjithatë, financimi është ende një problem pa zgjidhje, sidomos me afrimin e dixhitalizimit.

Ende nuk është vendosur një sistem efikas vetë-rregullimi, megjithë disa përpjekje në këtë drejtim. Duke pasur parasysh mungesën e kontratave të punës për gazetarët dhe tregun e punës jashtëzakonisht të paqëndrueshëm, vetëcensura është më e përhapur sesa vetërregullimi. Për më tepër, mungesa e studimeve, monitorimeve, sondazheve të besueshme dhe mënyrave të tjera për të mbledhur të dhëna për median elektronike vazhdon të jetë pengesë për një analizë më të saktë të tregut të medias shqiptare.

B. Rekomandimet

1. REKOMANDIMET FILLESTARE NGA RAPORTI I 2005¹

Shumë nga rekomandimet e raportit fillestar janë përmbushur, kryesisht në fushën e legjislacionit dhe shpërndarjen e reklamave dhe fondeve shtetërore. Organizatat ndërkombëtare kanë vazhduar mbështetjen e tyre për kërkimet, monitorimet dhe ndihmesën për legjislacionin. Edhe pse transmetuesi i shërbimit publik ka nisur një reformë serioze, është ende shumë herët për të vlerësuar se si janë përmbushur rekomandimet për transmetuesit e shërbimit publik. Nuk pati progres për rritjen e transparencës së pronësisë së transmetuesve dhe në zbatimin e Kodit të Punës në sektorin e medias.

¹“Shqipëria” në Institutin e Shoqërisë së Hapur, *Televizioni në Europë: rregullimi, politikat dhe pavarësia*, Budapest, 2005 (më tej OSI/Shqipëria), f. 247–250.

1.1 Politikat

<i>Legjislacioni</i>	
<p>1. Qeveria duhet të ndërmarrë hapa për të plotësuar boshllëqet në legjislacionin e medias, veçanërisht në lidhje me teknologjitë dhe shërbimet e reja të transmetimit, duke iu referuar instrumenteve ndërkombëtare mbi konkurrencën dhe transmetimin dixhital.</p> <p>2. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare duhet të vazhdojnë asistencën për qeverinë dhe parlamentin, si dhe për rregullatorin - Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) - për hartimin e legjislacionit të medias. Ata duhet të nxisin konsultimet me OJQ që veprojnë në fushën e medias së lirë dhe shoqatat e mediave profesionale, si pjesë e procesit të hartimit të ligjit.</p> <p>3. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare duhet të vazhdojnë asistencën e tyre për organizmat që merren me zbatimin e ligjit mbi përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të medias.</p>	<p>Këto rekomandime janë përmbushur pjesërisht. Ligji për Radion dhe Televizionin u ndryshua për të mbuluar dixhitalizimin dhe tashmë po rishikohet për ta përshtatur me legjislacionin e BE. Organizatat ndërkombëtare e mbështetën menjëherë reformën e autoriteteve rregullatore dhe atë të transmetuesit të shërbimit publik si dhe dhanë këshillat e tyre për legjislacionin. Kjo asistencë duhet të vazhdojë. Megjithatë, këshillimi i qeverisë me grupet vendase të interesit ka qenë sporadik dhe i bërë nën presion.</p>
<i>Debati Publik</i>	
<p>4. OJQ lokale që veprojnë në fushën e lirisë së shprehjes dhe të aksesit në informacion, si edhe organizatat që merren më gjerësisht me të drejtat civile, duhet të nxisin një debat publik mbi probleme të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e medias në një frymë të hapur dhe të paanshme, duke rritur ndërgjegjësimin sesi media ndikon mbi qytetarët. Një iniciativë e tillë duhet të mbështetet fuqimisht nga institucionet ndërkombëtare dhe ato europiane, të tilla si Bashkimi Europian, OSBE dhe Këshilli i Europës.</p>	<p>Vetë media i ka sjellë çështjet e lidhura me të në qendër të debatit publik. Por ekziston ende nevoja për një debat më të pasur publik për tema të rëndësishme të lidhura me zhvillimin e medias. OJQ-të lokale janë në pozitën më të përshtatshme për ta realizuar këtë.</p>

<i>Studimet</i>	
<p>5. Qeveria duhet të nxisë analiza të hollësishme për sektorin e medias, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë studimeve mbi audiencën. Për të siguruar pavarësinë e një studimi të tillë, qeveria duhet të funksionojë vetëm si një bashkëfinancues i punës së bërë nga institucione akademike, të vendit ose OJQ të huaja apo edhe institucione të tjera joshitetërore.</p> <p>6. Organizatat e shoqërisë civile duhet të nxisë qeverinë për të mbështetur një studim të tillë të pavarur në sektorin e medias.</p>	<p>Ky rekomanim nuk është plotësuar. Ende nuk ka një studim për shikueshmërinë, kështu që rekomandimi mbetet në fuqi.</p>
<i>Konsultimet</i>	
<p>7. Kur ndërmerr hapa që prekin median dhe merr në shqyrtim problemet që lidhen me të, Qeveria duhet të konsultohet me pronarët e medias, OJQ që veprojnë në fushën e lirisë së shtypit, shoqatat e medias profesionale, dhe komunitetin ndërkombëtar, dhe veçanërisht Këshillin e Europës.</p>	<p>Ky rekomandim nuk është përmbushur. E vënë nën presion, qeveria u këshillua me palët e interesuara për ndryshime në ligjet e medias. Megjithatë, ky këshillim u bë momentin e fundit dhe ishte një përjashtim.</p>
<i>Teknologjitë e reja</i>	
<p>8. Qeveria duhet të përgatisë një strategji afatgjatë për zhvillimin e medias që mund t'i paraprinte evolucionit të teknologjive të reja, duke përfshirë këtu internetin dhe transmetimin dixhital.</p> <p>9. Si një prioritet të saj Qeveria duhet t'i propozojë parlamentit amendime për Ligjin mbi Radion dhe Televizionin duke synuar rregullimin e transmetimit dixhital, në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare.</p>	<p>Rekomandimi i parë mbetet ende për t'u plotësuar. KKRT po harton një strategji për dixhitalizimin. Rekomandimi i dytë është përmbushur. Parlamenti e ndryshoi Ligjin për Radion dhe Televizionin për të përfshirë edhe masat për transmetimin dixhital, në përputhje me standardet ndërkombëtare.</p>

1.2 Autoritetet rregullatore (KKRT)

<i>Pavarësia</i>	
<p>10. Qeveria dhe parlamenti duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të legjislacionit ekzistues, në mënyrë që të respektohet dhe të përforcohet pavarësia e autoritetit rregullator, Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (KKRT), në mënyrë të veçantë në lidhje me emërimin e anëtarëve të KKRT dhe përgatitjen e raportit vjetor të KKRT.</p>	<p>Rekomandimi është plotësuar. Edhe pse ngjalli mjaft polemika, formula e emërimit të anëtarëve të KKRT u ndryshua. Megjithë reformën e vazhdueshme në vitet e fundit, qeveria dhe parlamenti duhet ende të ndërmarrin ndryshime në legjislacion për të forcuar pavarësinë e rregullatorit.</p>

1.3 Transmetuesit publikë dhe privatë

<i>Shumëllojshmëria e medias</i>	
11. Qeveria dhe parlamenti duhet të konsolidojnë transparencën e medias nëpërmjet zbatimit të plotë të legjislacionit të medias, dhe nëpërmjet kontrolleve të rregullta mbi pronësinë dhe financimin e medias.	Nuk ka patur shumë progres për të hedhur dritë mbi pronësinë e transmetuesve. Qeveria dhe Parlamenti duhet të bëjnë më tepër për ta arritur këtë gjë. Kontrollat e pronësisë dhe financimit të mediave duhen kryer nga agjenci zbatimi më të fuqishme, më efikase dhe më të pavarura, si KKRT apo Policia Tatimore.
<i>Për të drejtat e gazetarëve</i>	
12. Qeveria duhet të marrë hapa të veçantë që Kodi i Punës të zbatohet nga organizatat e mediave dhe të mbikqyrë rregullisht zbatimin e tij. 13. Shoqatat e gazetarëve, me ndihmën edhe të aktorëve të tjerë të shoqërisë civile, duhet të kërkojnë zbatimin e kodit të Punës në kompanitë e mediave, dhe në mënyrë të veçantë negociatat kolektive. 14. Organizatat e shoqërisë civile duhet të mbështesin gazetarët edhe individualisht, kur të drejtat e tyre dhunohen nga pronarët e mediave, autoritetet shtetërore ose palë të tjera.	Këto rekomandime nuk janë përmbushur. Qeveria nuk ka ndërmarrë hapa për të forcuar zbatimin e Kodit të Punës. (Këto hapa do të përfshinin edhe forcimin e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit, si Inspektoriat i Lartë i Punës dhe Policia Tatimore për të monitoruar rregullisht zbatimin e Kodit të Punës në të gjitha mediat.) Në të njëjtën kohë, shoqëria civile dhe shoqatat e gazetarëve kanë qenë të dobëta në kërkesën e tyre për zbatimin e Kodit në organizatat e mediave.
<i>Financimi</i>	
15. Qeveria duhet të krijojë një organizëm të pavarur që të jetë përgjegjës për transferimin e fondeve qeveritare tek operatorët e mediave, në përputhje me parimet dhe procedurat e parashtruara nga rekomandimet përkatëse të Këshillit të Europës. Procesi i transferimit të parave duhet të jetë i qartë dhe transparent.	Ky rekomandim është përmbushur. Qeveria ka krijuar Agjencinë e Prokurimeve Publike që boton një buletin javor të njoftimeve zyrtare, përfshirë reklamat shtetërore dhe njoftimet që më përpara botoheshin në gazeta. Megjithatë, ligji nuk është krejtësisht i qartë në përkufizimin e reklamës shtetërore dhe për pasojë ka nevojë për sqarim të mëtejshëm.
<i>Reklamat shtetërore</i>	
16. Qeveria duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershme për të siguruar transferimin e paparagjykuar dhe jopolitik të parave nga reklamat shtetërore dhe të rrisë transparencën mbi transferimin e parave nga kjo reklamë.	Qeveria ka ndërmarrë hapa për të garantuar një shpërndarje objektive të reklamës shtetërore. Megjithatë, sistemi i shpërndarjes së reklamës shtetërore ka ende nevojë për përmirësim.

<i>Pavarësia</i>	
17. Qeveria duhet të investigojë rregullisht pohimet mbi dhunimet e lirisë dhe të pavarësisë së medias.	Qeveria nuk ka treguar gatishmëri të madhe për të hetuar dhunimet e lirisë së medias rregullisht. Në këtë mënyrë, ky rekomandim ende qëndron.
<i>Studime dhe monitorim</i>	
18. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare duhet të monitorojnë dhe të raportojnë publikisht mbi dhunimet e pavarësisë së medias. 19. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare duhet të asistojnë me studime dhe monitorim fusha të veçanta të aktivitetit të medias, të tilla si pavarësia, respektimi i ligjit dhe etika e medias.	Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare kanë vazhduar ta përmbushin rolin e tyre monitorues. Puna e tyre monitoruese dhe kërkimore është thelbësore dhe duhet të vazhdojë.

1.4 Transmetuesi publik (RTSH)

<i>Reforma e RTSH</i>	
<p>20. Qeveria duhet të mbështesë transformimin e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) në një transmetues të vërtetë të shërbimit publik, duke bërë të qarta rolet dhe përgjegjësitë dhe duke garantuar transparencën e administrimit.</p> <p>21. Shoqatat e gazetarëve dhe organizatat ndërqeveritare duhet të ndërmarrin hapat e duhura nga ana e tyre për të mbështetur transformimin e RTSH.</p> <p>22. Qeveria dhe OJQ të rëndësishme të këtij sektori duhet të përpiqen të sjellin të gjithë aktorët në një debat publik mbi të ardhmen e RTSH. Kjo duhet të përfshijë gazetarët e RTSH, drejtorët e mëparshëm dhe ata të tanishëm, autoritetin rregullator (KKRT), OJQ dhe komunitetin e gazetarëve në përgjithësi.</p> <p>23. Shoqëria civile duhet ta sjellë përpara vëmendjes së publikut shqetësimet mbi RTSH dhe të kërkojë zgjidhje nga organet kompetente. Në lidhje me TVSH, këto shqetësime përfshijnë, por nuk janë të kufizuara me, cilësinë e programit, transparencën e administrimit, efikasitetin e administrimit, dhe pavarësinë nga qeveria dhe grupet politike.</p>	<p>Menaxhimi i ri i RTSH duket se ka nisur një reformë serioze. Është ende shumë herët për të nxjerrë përfundime për strategjinë e tij, por mund të thuhet me siguri se ai do të ketë nevojë për asistencë financiare dhe teknike dhe do të duhet të bëjë një menaxhim të mençur dhe efikas të burimeve.</p> <p>Prandaj, rekomandimet nga raporti fillestar janë ende të vlefshme. Qeveria duhet të mbështesë reformën e RTSH dhe shoqatat e gazetarëve duhet të organizojnë debate publike dhe të ofrojnë përvojën e tyre për të ndihmuar këtë reformë. Cilësia e programit, transparenca e administratës, si dhe efikasiteti i menaxhimit duhet të jenë ndër temat që shoqëria civile duhet të ketë në vëmendje të saj.</p>
<i>Financimi</i>	
<p>24. Qeveria duhet ta njohë dhe ta bëjë të ditur të ardhurën nga tarifat e licensave. Kur kjo të kryhet, atëherë duhet të mendohet për të gjetur rrugët për të përmirësuar nivelin e pagesës së kësaj tarife.</p>	<p>Ky rekomandim nuk është përmbushur. Qeveria duhet ende të rrisë transparencën për të ardhurat nga taksa e aparatit.</p>
<i>Programacioni</i>	
<p>25. Administrimi dhe stafi i Radio Televizionit Shqiptar (TVSH) duhet të përmirësojë cilësinë e produksionit dhe të përcaktojë një strukturë programi që do të rrisë interesin publik dhe do ta bënte më tërheqës këtë stacion televiziv.</p>	<p>Megjithë ndryshimet e fundit në RTSH, menaxhimi dhe stafi i stacionit duhet të përmirësojnë programacionin.</p>

1.5 Shoqëria civile

<i>Kodet e etikës</i>	
26. Shoqatat e gazetarëve duhet të përpilojnë kodet e etikës ose të amendojnë atë ekzistues, të rrisin ndërgjegjësimin për këto kode, dhe të promovojnë veprimin në përputhje me to.	Në shtator 2006, shoqatat e gazetarëve miratuan një kod etike për të gjitha mediat në vend. Megjithatë, kodi nuk është miratuar “zyrtarish” nga ndonjë media dhe ende nuk ka ndonjë mekanizëm për ta zbatuar atë. Gazetarët janë të lirë të vendosin nëse duan ta respektojnë atë apo jo. Një sistem efikas vetërregullimi dhe një ambient i sigurt për gazetarët mbeten ende qëllime të largëta.
<i>Shoqatat e mediave</i>	
27. Shoqatat e mediave duhet të forcojnë në mënyrë të ndjeshme aftësitë për debat publik dhe ndërgjegjësimin e organizatave dhe shoqatave të mediave nëpërmjet një bashkëpunimi më të mirë dhe duke promovuar të drejtat e gazetarëve përballë pronarëve të mediave dhe qeverisë. 28. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare duhet të ofrojnë eksperiencë dhe asistencë për konsolidimin e shoqatave të mediave.	Nuk ka pasur shumë përparim në këtë aspekt. Shoqatat e gazetarëve duhet të vazhdojnë të përmirësojnë kapacitetet e tyre. Organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, të cilat kanë asistuar procesin deri tani, duhet të vazhdojnë mbështetjen e tyre.

2. REKOMANDIMET E REJA SIPAS RAPORTIT TË 2008

2.1 Legjislacioni

Televizioni dixhital

1. KKRT duhet të hartojë një Strategji Dixhitalizimi dhe pastaj të nisë procesin e licensimit dixhital.
2. Hartimi i Strategjisë duhet të miratohet pas një debati publik me palët e interesuara. Strategjia duhet të marrë parasysh tema të tilla si mbrojtjen e konsumatorit, investimet në platforma dixhitale të bëra tashmë në vend, si dhe pluralizmin dhe konkurrencën në media.

C. Përfundimet kryesore të monitorimit vijues

1. AMBIENTI I PËRGJITHSHËM I TRANSMETIMEVE

1.1 Zhvillimet kyçe në legjislacion dhe politika

Që nga koha e botimit të “Televizioni në Europë” në 2005, përvoja e Shqipërisë ka qenë e pasur në aspektin e legjislacionit dhe politikave për median, me debate të nxehta rreth të ardhmes së autoriteteve rregullatore, transparencës së financimeve në media, si dhe transmetimeve numerike. Përbërja e autoriteteve rregullatore është ndryshuar me ligj. Ndryshime të tjera ligjore përpiquen të zvogëlojnë varësinë ekonomike të medias elektronike nga reklamat shtetërore dhe për pasojë dhe nga abuzimet e mundshme.

Pas debatesh të gjata dhe të gjalla mes pronarëve të medias, deputetëve, rregullatorëve, RTSH dhe shoqatave të industrisë, Shqipëria po përgatitet për të legalizuar platformën e saj dixhitale, sipas Ligjit për Transmetimet Dixhitale.² Transmetimet dixhitale në platformat satelitore dhe tokësore janë zhvilluar me shpejtësi gjatë tre viteve të kaluara, duke arritur një depërtim të rëndësishëm. Pas gati katër vitesh transmetimi, platforma televizive dixhitale DigitAlb pretendonte se kishte 120,000 abonentë në fillim të 2006 në Shqipëri dhe te shqiptarët që jetojnë jashtë.³ Caktimi i ndikimit të ligjit te DigitAlb dhe te abonentët e tij do të jetë një test i mëtejshëm për autoritetin rregullator. Nga ana tjetër, mbetet për t'u parë nëse transmetuesit e tjerë, sidomos TVSH, do të jenë në gjendje të investojnë në dixhitalizimin dhe të konkurrojnë me DigitAlb.

TVSH vazhdon të mos e përmbushë misionin e saj. Drejtuesit e caktuar në fund të 2006 përballen me detyrën e vështirë e kthimit të stacionit në një operator me të vërtetë publik, edhe pse vuan nga një rënie e vazhdueshme e popullaritetit, ndërkohë që audiencia e stacioneve private ka ardhur në rritje. Një hap tejet i vonuar në këtë drejtim u mor në gusht të vitit 2007, me hartimin e përbashkët të një strategjie për RTSH në erën dixhitale nga TVSH dhe Unioni Europian i Transmetimeve (EBU), me këshillimin e Divizionit të Medias së Këshillit të Europës.

1.2 Masat ligjore të BE

Shqipëria e ka miratuar pjesërisht legjislacionin dhe standartet europiane për median. Në vitin 1999, vendi firmosi dhe ratifikoi Konventën e Këshillit të Europës për Televizionin Ndërkufitar dhe Protokollin e tij Shtesë. Shumë nga masat e Ligjit për Radion dhe

² Ligji nr. 9742 i 28 maj 2007 në Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë (më tej Ligji për Transmetimet Numerike).

³ Sipas të dhënave nga DigitAlb (gjendet në <http://www.digitalb.tv/kompania/>, e parë në 31 korrik 2007).

Televizionin⁴ vijnë nga kjo marrëveshje dhe në një mënyrë përmbushin disa nga kërkesat e Direktivës Televizioni Pa Kufij (TVWF),⁵ si masat për sponsorizimet, reklamat, të drejtën e replikës dhe mbrojtjen e të miturve.

Legjislacioni shqiptar për median nuk ka përfshirë kërkesat e Direktivës TVWF për teleshtjjet dhe transmetimin e veprave europiane. Ligji për Transmetimet Numerike paraqiti kërkesën që veprat europiane duhet të përbëjnë 50% të programacionit të një stacioni, duke lejuar që kjo përqindje të arrihet në mënyrë progresive. Megjithatë, respektimi i këtyre standarteve duhet ende të monitorohet, pasi ky ligj është ende mjaft i ri. Kishte një ide për të caktuar një grup pune të përbërë nga tre ekspertë të pavarur të medias, të cilët do të rishikonin Ligjin për Radion dhe Televizionin dhe do të propozonin ndryshime që do ta sillnin këtë ligj në linjë me ligjet e BE. Deri tani kjo nuk u realizua. Komisioni i Përhershëm Parlamentar për Median dhe Mjetet e Informimit Publik (më pas Komisioni Parlamentar i Medias) po e kryen këtë detyrë, por ritmi është i ngadaltë, duke pasur parasysh përparësitë e çështjeve të tjera në Parlament, më saktësisht reformën në drejtësi. Megjithatë, ka përpjekje për të reformuar legjislacionin e medias. Rregullatorët dhe ekspertë të Komisionit Parlamentar të Medias kanë paraqitur propozimet e tyre për ndryshime ligjore, por ende nuk është e qartë se cilat do të jenë hapat në vijim.⁶

Edhe pse nuk ka patur një monitorim të vazhdueshëm se si janë zbatuar këto masa, nuk ka patur ndonjë problem të veçantë.⁷ Nga ana tjetër, zbatimi i masave të tjera të frymëzuara nga legjislacioni i BE për median, ka qenë jo i kënaqshëm. Si në shumë sektorë të tjerë në Shqipëri, edhe industria e medias ka mungesë transparence dhe ligjet që garantojnë transparencën e pronësisë dhe financimit mbeten të vështira për t'u zbatuar. Kjo për shkak të mungesës së përgjithshme të transparencës në treg. Një hap përpara ishte një amendim në korrik 2006 të Ligjit për Radion dhe Televizionin që i ndalonte pronarët e mediave të merrnin pjesë në tendera publikë.⁸ Megjithatë, sërish, për shkak të mungesës së përgjithshme të transparencës dhe dhënies së ulët të përgjegjësisë si nga ana e medias, ashtu edhe nga ana e qeverisë, kjo masë ligjore mund të anashkalohet me lehtësi.

⁴ Ligji nr. 8410 i 30 shtatorit 1998 për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr. 8657 i 31 korrikut 2000; Ligji nr. 8794 i 10 majit 2001; Ligji nr. 9016 i 20 shkurtit 2003; Ligji nr. 9124 i 29 korrikut 2003, dhe Ligji nr. 9677 i 13 janarit 2007 (më tej, Ligji i Radios dhe Televizionit).

⁵ Direktiva 97/36/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit në 30 qershor 1997, e cila amendon Direktivën e Këshillit 89/552/EEC për koordinimin e disa masave të hartuara me ligj, rregullim apo veprim administrativ në shtetet anëtare në lidhje me ndërmarrjen e veprimtarive të transmetimit televiziv, *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian*, L 202, 30 korrik 1997. Direktiva 2007/65/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit në 11 dhjetor 2007, e cila amendon Direktivën e Këshillit 89/552/EEC për koordinimin disa masave të hartuara me ligj, rregullim apo veprim administrativ në shtetet anëtare në lidhje me ndërmarrjen e veprimtarive të transmetimit televiziv, *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian*, L 332/27, 18 dhjetor 2007.

⁶ Intervistë me Vjollca Meçe, këshilltare pranë Kryetares së Parlamentit, Tiranë, 17 janar 2008.

⁷ Intervistë me Andrea Nathanailin, Drejtor Programacioni pranë KKRT, Tiranë, 6 korrik 2007.

⁸ Ligji i Radios dhe Televizionit, neni 20.

1.3 Tregu i transmetimeve

Stacionet televizive vazhdojnë të shtohen në numër dhe mund të argumentohet edhe që cilësia ka ardhur në rritje, por pa patur studime sistematike dhe të besueshme për shikueshmërinë, përqindja e vërtetë e tregut për çdo stacion mbetet e panjohur. Instituti i Sondazheve dhe Opinioneve, i cili më parë ka bërë përpjekje për të matur shikueshmërinë, ka nisur një përpjekje të re për studim shikueshmërie në vitin 2007. Megjithatë, është ende herët për të patur rezultate të qarta. Për shembull, Top Channel, një stacion që nuk ka patur licensë kombëtare deri në janar të 2008, mendohet se gëzon një përqindje mesatare shikueshmërie prej 70 përqind.⁹ Edhe pse nuk ka asnjë dyshim që stacioni është shumë i ndjekur, kjo shifër është një vlerësim i përafërt i ekspertëve dhe vëzhguesve, pa asnjë të dhënë zyrtare që ta mbështesë këtë. Stacionet e tjera më të ndjekura televizive mendohen se janë TV Klan, Vizion+, TV Koha, si dhe stacionet me lajme News24 dhe Alsat. Edhe pse TVSH ende ka mbulimin më të madh të territorit, “cilësia programore në ulje”¹⁰ ka sjellë humbjen e avantazhit të konkurrencës.

2. RREGULLIMI DHE LICENSIMI I SEKTORIT TË TELEVISIONIT

2.1 Autoritetet dhe korniza rregullatore

Deri në 2006, Ligji për Radion dhe Televizionin thoshte se KKRT ishte një organ i pavarur, i përbërë nga kryetari, nënkryetari dhe pesë anëtarë, të zgjedhur në bazë të përvojës dhe meritave në fushat sociale, ligjore, të arsimit dhe të medias. Presidenti i Republikës propozonte një kandidat, ndërsa gjashtë të tjerët propozoheshin nga Komisioni Parlamentar i Medias. Më pas Parlamenti zgjidhte anëtarët dhe kryetarin me votim me shumicë të thjeshtë.¹¹

Në shkurt 2006, qeveria propozoi një ndryshim ligjor që do të shkurtonte KKRT në pesë anëtarë dhe do të ndryshonte formulën e emërimit. Duke pretenduar se formula e përfaqësimit të balancuar në organin rregullator ishte e qartë që nuk funksiononte, qeveria propozoi një përfshirje më të gjerë të shoqërisë civile, shoqatave të medias, akademikëve dhe organizatave të tjera të ngjashme në procesin e emërimit. Propozimi ndezi një debat të gjallë dhe krijoi një klimë dyshimi mes palëve të interesuar, shumica e të cilëve mendonin se qeveria donte të vinte KKRT nën kontroll. Ndërkohë që të gjithë binin dakord se ekzistonte një nevojë e fortë për reformë, shumë të tjerë shprehën shqetësimin se ky propozim nuk garantonte ndonjë përmirësim: “Si anëtar i Komisionit Parlamentar të Medias, besoj se në këtë fushë duhen bërë ndryshime, por ta sjellësh këtë propozim fshehurazi, sidomos nga qeveria dhe sidomos kur po flasim për pushtetin e katërt që është media, kjo lë një shije të keqe.”¹²

⁹ A. Stefani, Të pavarurit, kali i Trojës në media, *Panorama*, 16 shkurt 2006, f. 17.

¹⁰ IREX, Media Sustainability Index 2006 – Shqipëria, IREX, Washington D.C., 2007, f. 6, Gjetet në website e IREX te http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/albania.asp (i parë në 1 gusht 2007) (më tej IREX, *MSI 2006 – Shqipëria*).

¹¹ OSI/Shqipëria, kapitulli për autoritetin rregullator, f. 194-199.

¹² N. Lesi, “A duhet të merremi me ligjin për mediat elektronike?”, *Koha Jonë*, 10 shkurt 2007, f. 3.

Përveç shqetësimit për përmbajtjen e amendamentit, shumë stacione televizive, shoqatat e gazetarëve, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të medias kundërshtuan mungesën e debatit dhe këshillimit përpara paraqitjes së amendamenteve në Parlament. Për pasojë, Komisioni Parlamentar i Medias ftoi pronarët dhe drejtorët e mediave më të rëndësishme, si dhe kryetarët e shoqatave të gazetarëve, juristë dhe përfaqësues të shoqërisë civile që të paraqisnin propozimet e tyre.

Ligji i tanishëm u miratua në parlament në maj 2006, pas një debati të nxehtë. Edhe pasi Presidenti vuri veton dhe e ktheu ligjin, ai u miratua sërish në qershor 2006 dhe u bë i detyrueshëm. Ideja e qeverisë për të shkurtuar anëtarët e KKRT në pesë anëtarë u pranua, me kusht që shoqatat dhe grupet e mëposhtme mund të propozojnë të paktën katër kandidatë për secilin anëtar:¹³

- shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike,
- shoqatat e medias së shkruar,
- universitetet dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike,
- shoqatat e juristëve, fakultetet e Ligjit dhe Dhoma Kombëtare e Avokatëve,
- partitë parlamentare.

Nga këta kandidatë, Komisioni i Medias duhet të përzgjedhë jo më shumë se dy kandidatë për çdo post dhe ua propozon ato Parlamentit për votimin përfundimtar.¹⁴ Ligji i ndryshuar thotë gjithashtu se kandidatët me grada shkencore janë të parapëlqyer dhe se këto grada janë të detyruara për kandidatët e nominuar nga universitetet dhe nga shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike.¹⁵

Ligji i ndryshuar për Radion dhe Televizionin gjithashtu ngushtoi kriteret për zgjedhje si anëtar i KKRT. Për shembull, anëtarët e partive ose shoqatave politike, ose personat që kanë qenë apo kanë konkurruar për postin e kryebashkiakut ose për deputet, apo që kanë qenë anëtarë të Këshillit të Ministrave apo prefektë në dy mandatet e fundit, nuk mund të zgjidhen.¹⁶ Ky ndryshim bënte pjesë në shndërrimin e KKRT në një organ më profesional.

Debati që pasoi zgjedhjen e anëtarëve të KKRT sipas formulës së re ishte akoma më i nderur. Anëtarët e rinj u emëruan në 29 korrik 2006 gjatë sesionit përfundimtar të Parlamentit para pushimeve verore. Deputetët e opozitës refuzuan të votonin. Emërimi i anëtarëve të KKRT, së bashku me ata të Këshillit Drejtues të TVSH, erdhi në një kohë kur kriza midis shumicës dhe politikaneve të opozitës kishte arritur kulmin. Arsyeja për këtë përplasje ishte mosmarrëveshja për ndryshimet në ligjin e transmetimeve dhe për reformën elektorale, e cila është ende në proces në Shqipëri. Por në verën e 2006, të gjitha këto çështje ishin veçanërisht

¹³ Ligji nr. 9531 i cili amendon Ligjin e Radios dhe Televizionit me kapitullin Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat, 11 maj 2006, *Fletorja Zyrtare*, nr. 65, 2006, neni 2, paragrafi 1.

¹⁴ *Ibid.*, paragrafi 2.

¹⁵ *Ibid.*, paragrafi 3 dhe 4.

¹⁶ *Ibid.*, neni 4.

polemizuese duke pasur parasysh që po afroheshin zgjedhjet lokale të shkurtit të 2007. Kur palët në parlament arritën marrëveshjen në 30 korrik 2006, ajo marrëveshje përfshinte edhe angazhimin për ta kthyer sërish numrin e anëtarëve të KKRT në shtatë dhe se dy anëtarët shtesë do të emëroheshin nga deputetët e opozitës nga kandidatët e shoqërisë civile.¹⁷

Megjithatë, në vend që të rritej, anëtarësia e KKRT u ul në katër anëtarë pas dorëheqjes së kryetarit Ledi Bianku në qershor 2007. Derisa vendet bosh u plotësuan në shtator 2007, KKRT ka marrë vetëm vendime që nuk kërkonin një shumicë. Kjo gjë pengoi punën e saj.

Ndërkohë, në një klimë dyshimi dhe kritikash nga politikanët e opozitës dhe nga disa stacione televizive që pretendonin se KKRT ishte ende një organ i politizuar, rregullatori ka kryer një reformë të brendshme. Në dhjetor 2006, parlamenti miratoi një rishikim të skemës administrative që e rriste stafin e KKRT nga 32 në 48,¹⁸ si dhe ristrukturonte departamentet e saj, duke theksuar përmirësimin e monitorimit si të piraterisë së sinjalit dhe të mbulimit territorial të medias elektronike. Gjithashtu skema propozonte të krijonte një njësi të marrëdhënive publike për të përmirësuar transparencën e rregullatorit. Reforma më e ndjeshme kishte të bënte me rritjen e departamentit të programacionit nga gjashtë anëtarë në 16, për të përmirësuar përmbajtjen e medias elektronike. Kur këto ndryshime të përfundojnë, departamenti pritet të jetë në gjendje të monitorojë edicionet informative përditë, si dhe reklamat, problemet etike dhe çështje të tjera që KKRT nuk i ka mbuluar më parë.¹⁹

Gjithashtu plani propozoi ndryshime në keshillin e ankesave të KKRT, një organ këshillimor, përgjegjës për trajtimin e aspekteve morale dhe etike të programeve. Megjithatë, vendimet e tij nuk kanë forcë ligjore.²⁰ Me planet për reformë, ky organ është ndryshuar në Këshill Etike. I përbërë nga tre anëtarë si më parë, të cilët janë ekspertë të medias të emëruar nga rregullatori, Këshilli i Etikës është përgjegjës për ndërgjegjësimin e publikut për normat etike dhe shkeljet në programe: “Ky vizion lind nga koncepti që institucionet jo vetëm duhet të ndjekin preferencat e publikut në lidhje me aspektet etike në media; me profesionalizëm dhe gjykim të specializuar ato duhet të udhëheqin shoqërinë drejt standarteve më të larta.”²¹

Në këtë mënyrë, Këshilli i Etikës pritet të marrë një rol më aktiv sesa thjesht të pranojë ankesa nga publiku. Megjithatë, është ende herët për të vlerësuar impaktin e këtyre ndryshimeve, pasi Këshilli u krijua në qershor 2007 dhe sapo e ka nisur veprimtarinë e tij. Plan i reformës është në fazën përfundimtare të zbatimit.²²

¹⁷ Marrëveshja e 30 korrikut 2006, i përmendur në D. Ndrenika, “Arrihet marrëveshja PD–PS; plotësohen kërkesat e opozitës”, *Shekulli*, 31 gusht 2006, f. 3.

¹⁸ KKRT, Relacioni Shpjegues për Parlamentin, i marrë nga KKRT.

¹⁹ *Ibid.*

²⁰ OSI/Shqipëria, kapitulli për autoritetin rregullator, f. 194–199.

²¹ KKRT, *Raport Vjetor në Kuvendin e Shqipërisë 2006*, gjendet në <http://www.kkrt.gov.al/images/stories/kkrt/files/Raporti-Perfundimtar-2006.zip>

(i parë në 15 korrik 2007) (më tej KKRT, Raporti Vjetor 2006).

²² Intervistë me Elona Kana, Drejtoreshë e Departamentit Juridik dhe të Licensave pranë KKRT, Tiranë, 18 janar 2008.

2.2 Sistemi i licensimit

Reforma e KKRT nuk pati pasoja për sistemin e dhënies së licensave të transmetimit. Ndryshimi i vetëm ka të bëjë me fuqinë për të dhënë licenca për transmetime numerike, një ligj ky që u miratua në qershor 2007, por mbetet ende për t'u zbatuar.²³

Përsa i përket licensimeve, dy nga vendimet e KKRT kanë ngjallur polemika në tre vitet e fundit: një kishte të bënte me dhënien e një license transmetimi një stacioni televiziv lokal dhe tjetri për heqjen e antenave të transmetimit të disa stacioneve televizive.

Në mes të prillit 2007, KKRT njoftoi për një inspektim të spektrit të frekuencave në të gjithë vendin. Mediat elektronike që operonin pa licenca u njoftuan se duhej të ndërprisnin transmetimet.²⁴ Sipas ish-kryetarit të KKRT, Ledi Bianku, ky pastrim i spektrit kishte për qëllim të mundësonte zbatimin e Planit të Frekuencave, duke fuqizuar kështu konkurrencën midis operatorëve ekzistues para fillimit të transmetimeve dixhitale.²⁵ Në 9 Maj 2007, KKRT vendosi të hiqte antenat e paautorizuara të transmetimit në disa qytete. Këto antena i përkisnin Top Channel TV, Vizion Plus TV, Telesport dhe TV Koha, të cilat e akuzuan rregullatorin se po merrte vendime politike dhe se po i hiqte antenat për shkak të qëndrimit kritik të këtyre televizioneve kundër qeverisë.

KKRT u përgjigj se inspektimi ishte lajmëruar para shtatë muajsh, në përputhje me kriteret ligjore të licensimit.²⁶ Bianku përsëriti se rregullatori ishte i detyruar të zbatonte planin kombëtar të frekuencave për të bërë vend për një transmetues të ri kombëtar dhe për lançimin e transmetimeve numerike.²⁷ Në fakt, një muaj pas këtij vendimi, KKRT njoftoi për një tender për një stacion televiziv të katërt kombëtar.²⁸ Top Channel dhe Vizion Plus aplikuan për licensën e re kombëtare dhe në 21 janar 2008 Top Channel u bë stacioni i katërt televiziv privat kombëtar.

²³ OSI/Shqipëria, kapitulli për autoritetin rregullator, f. 194–199.

²⁴ KKRT, Njoftim për Shtyp “Inspektimi i Gjithë Spektrit të Frekuencave në Shqipëri,” gjendet në <http://www.kkrt.gov.al/content/view/26/1/> (i parë në 15 qershor 2007).

²⁵ Studimi i vitit 2002 i KKRT për planin e frekuencave për televizionin analog u rrifreskua në 2007 sipas rishpërndarjes së frekuencave sipas vendimeve të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve në 2006 (RRC-06).

²⁶ Njoftim për shtyp i KKRT, “KKRT do të plotësojë Planin e Inspektimit të Spektrit,” 10 maj 2007, Gjendet në <http://www.kkrt.gov.al/content/view/33/> (parë në 10 qershor 2007); shih gjithashtu: Intervistë e pabotuar me Ledi Biankun, Kryetar i KKRT, gjendet në <http://www.kkrt.gov.al/content/view/33/1/> (parë në 10 qershor 2007). (Bëhet fjalë për një intervistë që një gazetë shqiptare zhvilloi me kryetarin e KKRT dhe më vonë nuk u botua. KKRT e botoi intervistën në faqen e saj të Internetit).

²⁷ Ibid.

²⁸ Njoftim për shtyp i KKRT, gjendet në <http://www.kkrt.gov.al/content/view/31/1/> (parë në 10 qershor 2007).

Paralelisht me këtë tender, KKRT rinisi fushatën e heqjes së antenave të paligjshme në tetor 2007 në Elbasan dhe Korçë. Në Gjirokastër KKRT gjithashtu konfiskoi antenat dhe pajisjet e disa kanaleve televizive greke që po transmetonin pa licenca në jug të vendit.²⁹

Saga e antenave televizive u parapri nga një debat tjetër që lidhej me dhënien e një license transmetimi një stacioni lajmesh të vendosur në Tiranë. KKRT, me anëtarësinë e mëparshme, e kishte ngrirë procesin e licensimit për Tiranën dhe Durrësin në maj 2003.³⁰ Në 17 qershor 2006, KKRT vendosi të ngrinte procesin e licensimit në të gjithë vendin.³¹ Të dyja vendimet niseshin nga kaosi që kishte pushtuar spektrin e frekuencave, sidomos përreth kryeqytetit, si dhe nga mungesa e planit kombëtar të frekuencave.³² KKRT e tanishme tha se asnjë nga këto vendime nuk kishte bazë ligjore;³³ e kundërta, ato ishin “absurde” dhe “diskriminuese,” pasi KKRT e mëparshme kishte dhënë licenca në zona ku vetë kishte ndaluar licensimin e stacioneve televizive.³⁴ Kështu, KKRT i dha fund ngrirjes së licensave dhe hapi dritën e gjelbër për licensimin e 21 operatorëve të rinj, ndër të cilët shtatë stacione televizive lokale, 12 televizione kabllorë dhe dy radio lokale në 2006 dhe në fillim të 2007.³⁵

Vendimi më i diskutueshëm lidhej me Ora TV, një kanal që transmeton vetëm lajme. Disa palë, përfshirë edhe stacione të tjerë televizivë, gazetarë dhe politikanë të opozitës thanë se Ora TV nuk duhej të kishte marrë licensë. Zëri më kritik ishte ai i News24 TV, stacion lajmesh nga më të ndjekurit, i cili pretendoi se KKRT kishte shkelur ligjin duke licensuar një kompani që nuk e kishte kapitalin e nevojshëm për të hapur një televizion. Kjo sepse Ora sh.p.k., kompania që zotëron Ora TV, pranoi se kishte një kapital prej ALL 100,000 (€8,160), ndërsa minimumi i kërkuar nga rregullatori ishte një garanci prej ALL 25 milion (€2,040,000).³⁶

Për më tepër, News24 TV aludoi se Ora TV kishte konflikt interesi, pasi Ilda Prifti, pronarja e Ora sh.p.k.,³⁷ ishte kushërira e Alba Ginës, e cila zotëron 40 përqind të kompanisë që zotëron TV Klan, televizion kombëtar, sipas artikujve në shtyp.³⁸ Ligji ndalon pronarët e një transmetuesi kombëtar të zotërojnë aksione drejtpërdrejt ose tërthorazi në një transmetues tjetër.³⁹ Në këtë rast nuk kishte shkelje të dukshme të ligjit, pasi pronarët ishin individë të ndryshëm. Megjithatë, kritikët theksuan faktin që Prifti, e cila ishte 18 vjeç kur Ora TV mori licensën, nuk i kishte përvojën profesionale dhe kapitalin për të krijuar një kanal televiziv dhe

²⁹ Njoftimet për shtyp të KKRT, tetor 2007, gjenden në <http://www.kkrt.gov.al/content/archivecategory/2007/10/1/> (parë në 24 janar 2008).

³⁰ Vendimi nr.143 i KKRT, cituar në Raportin Vjetor të KKRT 2006, f.6.

³¹ Vendimi nr. 501 i KKRT, cituar në Raportin Vjetor të KKRT 2006, f.6.

³² Intervistë me ish-kryetarin e KKRT, Sefedin Çela, “Të gjitha gabimet e Biankut dhe Dodës për licensën e re”, *Gazeta Shqiptare*, 25 dhjetor 2006, f. 7.

³³ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 7.

³⁴ *Ibid.*, f.8.

³⁵ *Ibid.*, f.15.

³⁶ *Ibid.*

³⁷ Informacion i marrë nga autori prej KKRT, Departamenti Juridik dhe i Licensave, 13 korrik 2007.

³⁸ *Ibid.*

³⁹ OSI/Shqipëria, sektori mbi transmetuesit privatë, f. 226.

ishite thjesht një kukull që fshihte pronarët e vërtetë.⁴⁰ Pas ankesave të bëra nga News24 TV, Prokuroria e Përgjithshme nisi një hetim për këtë çështje në dhjetor 2006. Duke këmbëngulur se vendimi i saj ishte në përputhje të plotë me ligjin, KKRT pretendoi se ajo ishte këshilluar edhe me Autoritetin për Konkurrencën dhe Zyrën e Regjistrimit Tregtar.⁴¹

Sipas ligjit të transmetimeve, KKRT është përgjegjëse për dhënien e licensave për transmetimet numerike. Ligji bën dallimin midis tre lloj licensave: për siguruesit e shërbimit, për operatorët e rrjetit dhe për siguruesit e përmbajtjes.

Licensat për rrjetet numerike tokësore ndahen si më poshtë:

- *kombëtare* (e vlefshme për dhjetë vjet) kur mbulojnë jo më pak se 80 përqind të vendit,
- *rajonale* (e vlefshme për tetë vjet) kur mbulojnë deri në katër njësi administrative në kufi gjeografikë me njëra-tjetrën,
- *lokale* (e vlefshme për tetë vjet) kur mbulojnë vetëm një njësi administrative.⁴²

KKRT duhet të japë licensat në përputhje të plotë me Planin e Frekuencave të miratuar nga RRC-06. Nëse një operator dixhital planifikon të ndërtojë një rrjet duke përdorur një frekuencë që është e zënë nga një operator analog, atëherë KKRT duhet t'i japë një frekuencë tjetër operatorit analog dhe të mbulojë shpenzimet e transfertës. Nëse rregullatori nuk mund t'i mbulojë këto shpenzime, kostot duhen mbuluar edhe nga operatori dixhital.⁴³

Ligji i detyron operatorët analogë të vazhdojnë të transmetojnë derisa përqindja e familjeve që ndjekin transmetimet analoge të bjerë poshtë 10 përqind të tërë zonës së transmetimit. Nga ana tjetër, RTSH ka të drejtën të përdorë dy nga shtatë frekuencat kombëtare të caktuara nga RRC-06 për përdorim dixhital për Shqipërinë.

KKRT është gjithashtu përgjegjëse për licensimin e siguruesve të përmbajtjes.⁴⁴ Licensat mund t'u jepen transmetuesve për të transmetuar ose një program televiziv apo radiofonik, ose një "buqetë" programesh. Çdo shërbim programi gjithashtu duhet të licensohet nga KKRT, e cila përcakton kriteret dhe kushtet për programet si dhe të drejtat dhe detyrimet e të licensuarit. Në këtë kuadër, transmetuesit ekzistues analogë mund të konsiderohen tashmë të licensuar si sigurues të përmbajtjes derisa sinjali analog të fiket.

Ligji gjithashtu vendos disa detyrime për operatorët e rrjeteve numerike. Ato duhet të ofrojnë të paktën 50 përqind të shërbimeve të tyre falas, ndërsa transmetuesi i shërbimit publik nuk mund të kërkojë pagesë për ndonjë program të vetin.

⁴⁰ Gazmend Janku, "Prokuroria nis hetimin për skandalin e licensës në KKRT," *Gazeta Shqiptare*, 24 dhjetor 2006, f. 10.

⁴¹ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 18.

⁴² Ligji i Transmetimeve Numerike, neni 3.

⁴³ *Ibid.*, neni 3.

⁴⁴ *Ibid.*, neni 5.

Edhe pse KKRT ende nuk ka nisur të japë licensa numerike, i ka vendosur tashmë kriteret për dhënien e licensave për operatorët e rrjetit.⁴⁵ Këto kriteret kërkojnë një kapital minimal prej ALL 1 bilion (Lek), ose €8.17 milionë, për licensë kombëtare, ose ALL 400 milionë (€3.27 milionë) për një licensë rajonale, si dhe ALL 100 milionë (€817,000) për një licensë lokale. Përveç kësaj, transmetuesit numerikë duhet të përmbushin disa kërkesa të tjera, përfshirë këtu korrektësinë dhe pavarësinë editoriale në shërbimet e tyre të lajmeve dhe ato informative.

Në pamje të parë, kriteret e licensimit duken të drejta dhe në ndihmë të publikut, sidomos përse i përket theksit për të zgjedhur standarde jo-ekskluzive, transparencës së kostove dhe zgjedhjes së larmishme të përmbajtjes. Rregullatori ka fuqinë të mbikqyrë kriteret e licensimit dhe të zgjedhë të licensuarit. Normalisht kjo kërkon një autoritet të pavarur, të fuqishëm dhe profesional. Fatkeqësisht, megjithë progresin e bërë, KKRT ende duhet të provojë që i meriton plotësisht këto epitete.

Edhe pse procesi i licensimit dixhital ende duhet të fillojë, televizioni dixhital ka mbërritur në Shqipëri kur DigitAlb nisi transmetimet në 15 korrik 2004, megjithë kundërshtimin e fortë si nga autoriteti rregullator, ashtu edhe nga stacionet e tjera televizive. DigitAlb është në transmetim për gati katër vjet tashmë, duke pasur një numër gjithnjë në rritje abonentësh: 120,000 në fillim të 2006, sipas shifrave më të fundit që disponohen.⁴⁶ Kompania ka deklaruar që numri i abonentëve është rritur që atëherë. Deri në 2006 DigitAlb mbulonte me sinjal Shqipërinë Perëndimore, nga Shkodra në veri deri në Vlorë në jug.⁴⁷ Për momentin, kompania pretendon se mbulon të gjithë vendin.⁴⁸ Megjithatë, sipas ligjit për transmetimet numerike, veprimtaria e saj mund të bëhet problematike pasi mbulimi me sinjal nga kompania do të kërkonte katër licensa kombëtare, ndërkohë që ligji thotë se asnjë operator nuk mund të marrë më shumë se një licensë kombëtare. DigitAlb ofron një buqetë tokësore me 38 kanale tematike dhe të përgjithshme, si dhe me dy stacione radiofonike. Për të qenë në rregull me ligjin, stacioni do të duhej të shkurtohej në mënyrë drastike numrin e kanaleve të ofruara. Kjo do të jetë akoma më e ndërlikuar pasi tashmë DigitAlb ka një numër të rëndësishëm klientësh dhe shumë pak kompani duket se kanë interes për të hyrë në këtë sektor të ri dhe mjaft të kushtueshëm.

Në fakt, debatet që paraprindë miratimin e ligjit u përqendruan në pasojat që ai do të kishte në tregun ekzistues, ku DigitAlb është kthyer në një lojtar të suksesshëm. Përfaqësuesit e DigitAlb këmbëngulën që ata nuk kërkonin gjë tjetër veçse legalizimin e veprimtarisë së tyre, pa u dashur t'ia nisnin nga zeroja.⁴⁹ Qeveria e paraqiti ligjin në parlament në shkurt 2007, në një kohë kur parlamenti kishte miratuar – në bashkëpunim me Këshillin e Europës – një plan veprimi për të rishikuar legjisllacionin e medias dhe për të hartuar një ligj për transmetimet numerike deri në fund të vitit. Pronarët dhe drejtorët e medias protestuan faktin që nuk ishin këshilluar për një ligj kaq të rëndësishëm. Për më tepër, pas disa seancave dëgjimore me palët

⁴⁵ Kriteret e KKRT për licensimin numerik.

⁴⁶ Faaja e DigitAlb në Internet, gjendet në <http://www.digitalb.tv/kompania/> (parë në 12 mars 2008).

⁴⁷ Intervistë me Altin Petre, Menaxher IT i DigitAlb, Tiranë, 16 maj 2006.

⁴⁸ Faaja në Internet e DigitAlb, <http://www.digitalb.al/kompania.php> (parë në 17 mars 2008).

⁴⁹ Minutat e Mbledhjes së Komisionit Parlamentar të Medias, 20 prill 2007, gjendet në <http://www.parlament.al/dokumenti.asp?id=2351&kujam=Komisioni> (parë në 18 tetor 2007).

e interesuara dhe pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), Këshilli i Europës dhe Komisioni European, shumica qeverisëse e miratoi ligjin pa miratimin e pakicës, e cila nuk pranoi të votonte. Debati për amendamentet e ligjit nuk u përqendrua shumë në qëllimin dhe pasojat e tyre, gjë që ngre pikëpyetje se me sa efikasitet do të zbatohet ky ligj.

Ligji nuk specifikon një datë për fikjen e sinjalit analog, edhe pse i detyron transmetuesit që programet e tyre të gjenden si në sinjalin analog, ashtu edhe në atë numerik, derisa sinjali numerik të arrijë në më shumë se 90 përqind të zonës së licensuar. Kjo masë mund të nxisë siguruesit e shërbimit dhe operatorët e rrjetit të përshpejtojnë procesin e dixhitalizimit, por nga ana tjetër, transmetuesit do të kenë kosto më të larta gjatë periudhës së transmetimit simultan. Për më tepër, do të jetë e vështirë të përshpejtohet procesi i dixhitalizimit pa ndihma nga shteti për dekoderat.

Që nga miratimi i ligjit, KKRT është këshilluar me DigitAlb për kriteret e licensimit. KKRT është ndihmuar nga OSBE për të hartuar Strategjinë për Kalimin në Transmetime Numerike. Procesi i licensimit dixhital mbetet i ngrirë derisa të miratohet Strategjia, e cila duhet ende të përfundohet dhe të botohet. Ajo duhet të marrë parasysh edhe rolin e DigitAlb.

3. RREGULLIMI DHE MENAXHIMI I TRANSMETUESIT TELEVIZIV TË SHËRBIMIT PUBLIK

3.1 Legjislacioni dhe politikat për transmetuesin publik

Amendamentet e 2006 për Ligjin e Radios dhe Televizionit, i cili rregullon RTSH, patën pasoja në rregullimin e transmetuesit të shërbimit publik. Megjithatë, masat kryesore për misionin publik të stacionit dhe për përmbajtjen janë të njëjtat.

Legjislacioni i ri për transmetimin dixhital i jep një rol të veçantë RTSH. Dy nga shtatë frekuencat kombëtare që i janë caktuar Shqipërisë deri në 2015 i rezervohen RTSH. KKRT i ka rekomanduar RTSH që kanalën e dytë ta transmetojë drejtpërdrejt në mënyrë dixhitale.⁵⁰ Në fakt, në korrik 2007, TVSH përgatiti një plan reforme në bashkëpunim me Unionin European të Transferimit (EBU), i cili përqendrohet në kalimin në dixhitalizim. Është ende herët për të parashikuar nëse kjo strategji do të jetë e mundur dhe e suksesshme. Është e sigurt që do të nevojitet mbështetje të bollshme financiare, si dhe një zbatim i rreptë dhe energjik nga TVSH.

3.2 Struktura qeverisëse e transmetuesit publik

Këshilli Drejtues mbetet organi më i lartë i RTSH. Deri në korrik 2006, ai përbëhej nga 15 anëtarë, të caktuar nga parlamenti për një periudhë pesë-vjeçare, me mundësinë për t'u

⁵⁰ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 21.

rizgjedhur pas një periudhe pushimi tre-vjeçar. Anëtarët duhej të zgjidheshin ndër personalitete të njohura nga fushat e kulturës, artit, kinemasë, gazetarisë, ligjit, ekonomisë, medias, marrëdhënieve publike, marrëdhënieve ndërkombëtare, universiteteve dhe Akademisë së Shkencave. Me këtë formulë, anëtarët propozoheshin në numër të barabartë nga shumica qeverisëse, opozita dhe shoqëria civile. Opozita e atëhershme mendonte se kjo formulë çenonte pavarësinë e institucionit, duke argumentuar se në fakt përfaqësuesit e shoqërisë civile mbështesnin shumicën parlamentare. Është e vështirë të vlerësohet nëse kjo ishte e vërtetë. Mbështetësit e kësaj formule paraqitën argumentin se e kundërta ishte e vërtetë: kjo ishte e vetmja mënyrë për të garantuar elementin e domosdoshëm të shoqërisë civile në anëtarësinë e institucionit publik.

Shumica e tanishme qeverisëse paraqiti një ndryshim të ligjit në shkurt 2006 që kishte për qëllim të ndryshonte formulën dhe përbërjen si të KKRT, ashtu edhe të Këshillit Drejtues të RTSH, në mënyrë që organet qeverisëse të RTSH t'i bënin ballë politizimit. Ish-Kryetari i Këshillit Drejtues, Kiço Blushi, shpjegoi: “Nuk jemi ne ata që vendosin, por ata, kryetarët e partive, që duan që drejtorët dhe anëtarët e këshillit të sillen si kukulla pa dinjitet, të cilët kontrollohen me lehtësi nëpërmjet celularëve.”⁵¹ Pas një debati të zgjatur dhe të nxehtë, amendamentet u miratuan në korrik 2006, megjithë protestat e opozitës.

Sipas ligjit të ndryshuar, anëtarët e Këshillit Drejtues u reduktuan nga 15 në shtatë.

Logjika dhe procedura e emërimit janë të ngjashme me ato për KKRT. Shoqatat dhe grupet e mëposhtme mund të propozojnë të paktën katër kandidatë për secilin anëtar të Këshillit Drejtues:⁵²

- Shoqatat e medias elektronike dhe të shkruar,
- Universiteti i Tiranës,
- Shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike,
- Shoqatat e juristëve, akademikëve të ligjit, si dhe Dhoma Kombëtare e Avokatëve,
- Grupet parlamentare,
- OJQ që merren me të drejtat e njeriut dhe të të miturve,
- borde këshillimi të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe Lidhjes së Shkrimtarëve.

Komisioni Parlamentar i Medias ka detyrën e përzgjedhjes deri në dy kandidatë për secilin post.⁵³ Preferohen kandidatët me grada shkencore. Grada të tilla janë të detyruara për kandidatët e propozuar nga universiteti dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike.⁵⁴ Në mënyrë që të garantohet vazhdimësia, kryetari dhe tre anëtarë zgjidhen për një mandat pesë-vjeçar, ndërsa tre të tjerët zgjidhen për një mandat tre vjet e gjysmë.⁵⁵

⁵¹ Kiço Blushi, “Televizioni që ka mbetur peng i partive”, *Standard*, 17 mars 2006, f. 23.

⁵² Ligji nr. 9531, 11 maj 2006, *Fletorja Zyrtare*, 65, 2006, Art. 2, paragraf 1.

⁵³ *Ibid.*, paragraf 2.

⁵⁴ *Ibid.*, paragrafët 3 & 4.

⁵⁵ *Ibid.*, neni 9.

Sipas ligjit të vjetër, deputetët, ministrat, zyrtarët e lartë të qeverisë, anëtarët e kryesive të partive politike, punonjës të RTSH ose punonjës dhe pronarë të mediave private nuk lejoheshin të bëheshin anëtarë të Këshillit Drejtues. Sipas ligjit të ri, u shtuan edhe kufizime të tjera. Tashmë nuk lejohen të jenë anëtarë edhe njerëz që zotërojnë aksione ose kanë lidhje me pronarë aksionesh në kompani që operojnë në transmetimet audiovizuale, reklamë, produksion, shtyp, telekomunikacione, si dhe anëtarë dhe/ose punonjës të strukturave qeverisëse të këtyre strukturave. Persona që janë larguar nga shërbimi civil për arsye disiplinore dhe punonjës aktualë apo që kanë punuar në RTSH gjatë tre vjetëve të fundit nuk mund të zgjidhen.

Opozita dhe disa vëzhgues të tjerë paraqitën argumentimin se përbërja e re e Këshillit Drejtues të RTSH nuk ofronte garanci për pavarësinë editoriale: “Të ashtuquajturit përfaqësues të pavarur deri më sot kanë qenë ‘kali i Trojës’ së politikës në këto institucione. Me qëllim që të shmangim rrezikun që ‘të pavarurit’ t’i shërbejnë pushtetit ose partive politike në vend të publikut, nevojitet që edhe [përfaqësimi i] të pavarurve të jetë gjithashtu [politikisht] i balancuar.”⁵⁶

Këshilli Drejtues u zgjodh nga shumica qeverisëse në korrik 2006 me formulën e re. Megjithatë, pasi opozita nuk pranoi të bashkëpunonte në reformën e procedurës elektorale para zgjedhjeve lokale të 2007 dhe atyre presidenciale, koalicioni qeverisës ra dakord të ndryshonte sërish përbërjen e Këshillit. Sipas marrëveshjes së gushtit 2006 midis deputetëve të shumicës dhe të opozitës, përbërja e Këshillit Drejtues do të rritej nga shtatë në 11 anëtarë dhe katër anëtarët e tjerë do të emëroheshin nga anëtarët e opozitës në Komisionin Parlamentar të Medias nga radhët e shoqërisë civile.⁵⁷ Megjithatë, Këshilli funksionoi vetëm me shtatë anëtarë deri në shtator 2007, pasi Parlamenti nuk arriti të zgjidhte anëtarët e tjerë si në KKRT, ashtu edhe në Këshillin Drejtues, për shkak të krizës së vazhdueshme presidenciale dhe vazhdimit të punës për Ligjin për Transmetimet Numerike. Sërish, mosmarrëveshjet politike dhe prirja për t’u pozicionuar dhe jo për t’u bashkuar për të mirën e përbashkët kanë penguar funksionimin normal dhe të pavarur të organit rregullator të stacionit.

Në Raportin Vjetor të 2006, Këshilli Drejtues theksoi vështirësitë me të cilat përballej dhe lavdëroi përparimin e transmetuesit publik në aspektin e pavarësisë editoriale dhe strukturës programore. Përveç kësaj, ndërsa bënte thirrje për asistencë më të madhe të qeverisë ndaj RTSH, Parlamenti angazhohej të hartonte dhe miratonte planin e plotë për reformë të RTSH deri në fund të 2007. Në gusht 2007 RTSH hartoi një strategji zhvillimi për periudhën 2008-2010, të cilën ia paraqiti qeverisë. Duke qenë i zënë me ligje të tjera, Parlamenti deri tani nuk ka arritur ta diskutojë këtë strategji.

Drejtori i Përgjithshëm vazhdon të gëzojë autoritet të konsiderueshëm, duke i raportuar Këshillit Drejtues por pa qenë i detyruar të zbatojë urdhrat e tij.⁵⁸ Këshilli Drejtues ka për detyrë të emërojë dhe ka të drejtën të shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm. Këshilli që u emërua në 2006 pushoi Drejtorin e Përgjithshëm të atëhershëm, Artur Zhejin, mbi baza

⁵⁶ A. Stefani, “‘Të pavarurit’, kali i Trojës në media,” *Panorama*, 16 shkurt 2006, f. 17.

⁵⁷ Marrëveshja e 30 korrikut 2006 e cituar në Denion Ndrenika, “Arrihet marrëveshja PD-PS; plotësohen kërkesat e opozitës”, *Shekulli*, 31 gusht 2006, f. 3.

⁵⁸ OSI/Shqipëria, f. 214–216.

keqadministrimi dhe mungesë reforme, duke pretenduar se varësia politike ishte ende e ndjeshme. Në një letër publike, Mero Baze, anëtar i Këshillit Drejtues, shkruante se “me vetëdijen e plotë të drejtorëve të saj, RTSH e ka shmangur debatin publik për vite dhe është kthyer në një stacion thuajse banal, i cili i ka shërbyer vetëm interesave të ngushta të drejtorëve të vet dhe të lidhjeve të tyre politike.”⁵⁹

Zheji e kundërshtoi kritikën dhe tha se shkarkimi i tij ishte kundër parimeve demokratike. “Është e pamundur të nisësh reformën e RTSH duke shkelur një nga parimet e demokracisë së medias, siç është mandati i Drejtorit të Përgjithshëm.” Ai shtoi se shkarkimi i tij ishte një vendim i nxituar, i bazuar më tepër në lidhjet politike sesa në arsye pragmatike.⁶⁰ Drejtori i Përgjithshëm i tanishëm, Petrit Beci, u zgjodh në 10 nëntor 2006. Beci më parë ka qenë Zëvendës Drejtor i transmetuesit publik dhe ka një përvojë të gjerë si menaxher i njërit prej televizioneve private kombëtare.

Shtresa e tretë e pushtetit në transmetuesin publik është Këshilli i Menaxhimit, i cili shërben si organ këshillimor për Drejtorin e Përgjithshëm, duke këshilluar Drejtorin për një sërë çështjesh të rëndësishme financiare apo në lidhje me pronat. Pa pasur asnjë rol në programacion, dhënia e pëlqimit të Këshillit të Menaxhimit është i detyrueshëm në disa vendime, si transaksionet e pronave, kontratat e punësimit dhe bisedime dhe marrëveshje të tjera me stafin dhe sindikatat.

Struktura qeverisëse ka për qëllim të garantojë punën e balancuar dhe të paanshme të RTSH, si dhe legjitimitetin e tij si institucion publik. Fatkeqësisht, kjo nuk është arritur. Në fakt, shumë vëzhgues, përfshirë anëtarë të strukturave qeverisëse të RTSH, ankohen që mënyra se si është ndërtuar sistemi është burimi kryesor i problemit. Anëtarët e Këshillit Drejtues thonë se fuqitë e tyre përballë Drejtorit të Përgjithshëm janë mjaft të kufizuara. Disa anëtarë thonë se vendimet kryesore merren nga Drejtori i Përgjithshëm, ndërsa roli i tyre në vendimmarrje është i parëndësishëm. Për shembull, ish-kryetari i Këshillit Drejtues, Kiço Blushi, pretendonte se “për dy vjet Këshilli [Drejtuës] nuk kishte miratuar struktura programore të përshtatshme për shkak të nënshtrimit politik të Drejtorit të Përgjithshëm, i cili emërohet nga ne, por nuk zgjidhet nga ne”.⁶¹

3.3 Financimi i transmetuesit publik

Pagesa e taksës vjetore për RTSH është ALL 500 (€4.1) për familje. Kjo taksë mendohet të përbëjë një nga burimet kryesore të të ardhurave për transmetuesin e shërbimit publik. Deri në 2006, buxheti i RTSH nuk e detajonte shumën totale të mbledhur nga taksa e aparatit.

Raporti i stacionit për 2006 tregonte një rritje prej 362 përqind në të ardhurat e taksës nga aparatit, nga ALL 19 milion (€155,000) të planifikuara në ALL 68.7 milion (€563,000) të realizuara.⁶² Megjithatë këtë rritje spektakolare, llogaritjet dëshmojnë se të ardhurat përfaqësojnë taksën e aparatit të paguar nga afërsisht 8,600 familje, shifër mjaft e ulët në një vend me

⁵⁹ Mero Baze, “Përse ndryshimi në RTSH duhet të nisë nga Drejtori i Përgjithshëm?”, *Shqip*, 26 tetor 2006, f. 11.

⁶⁰ Artur Zheji, “Stili vrasar i një shkarkimi”, *Shqip*, 28 tetor 2006, f. 7.

⁶¹ Kiço Blushi, “Televizioni që ka mbetur peng i partive”, *Standard*, 17 mars 2006, f. 23.

⁶² RTSH, *Raporti Vjetor për Veprimtarinë e RTSH 2006*, Këshilli Drejtues i RTSH, 2007, f. 15. (më tej Raporti Vjetor i RTSH 2006).

tre milion banorë dhe me më shumë se 500,000 shtëpi me televizor.⁶³ Në këtë mënyrë, një mbledhje më efikase e taksës së aparatit është mjaft e nevojshme, pasi kjo mund të jetë thelbësore në arritjen e pavarësisë së TVSH nga buxheti i shtetit.

Taksa për aparatit mblidhet në janar, së bashku me faturën e energjisë elektrike. Deri në 2006, Korporata Elektro-energjitike Shqiptare (KESH) ia kalonte paratë e mbledhura nga taksa e aparatit buxhetit të shtetit dhe atëherë Ministria e Financës i kalonte fondet në RTSH, pa bërë të ditur sa ishte mbledhur nga KESH. Në 2006, RTSH firmosi një marrëveshje me KESH dhe Drejtorinë e Taksave, e cila siguronte pagesën e drejtpërdrejtë të taksës së aparatit te RTSH. Megjithatë, për shkak të vështirësive të fundit ekonomike, nuk pritet që KESH ta përmirësojë vjeljen e taksës së aparatit në të ardhmen e afërt.⁶⁴

Të ardhurat e fituara nga vetë stacioni janë rritur në vitet e fundit, duke arritur deri në 65 përqind të buxhetit total të RTSH në 2006.⁶⁵ Megjithatë, RTSH është ende e ngadaltë në tërheqjen e të ardhurave të rëndësishme nga reklama. Stacioni arriti të vilte vetëm 44 përqind të të ardhurave të planifikuara nga reklama në 2006. Ndoshta kjo kishte të bënte edhe me konkurrencën nga stacione private më të fuqishme. Përveç kësaj, edhe financimi nga buxheti i shtetit u ul. Në 2006, TVSH mori ALL 300 milion (€2.46 milion) nga buxheti i shtetit, që përbën pothuajse gjysmën e shumave të marra në vitet e kaluara.⁶⁶ Financimi nga buxheti i shtetit u rrit në mënyrë modeste sërish. Në 2007, ndihma e buxhetit të shtetit për RTSH ishte ALL 312 milion (€2.52 milion).⁶⁷ Në 2008, shteti i dha ALL 438 milionë (€3.65 milion) RTSH-së.⁶⁸

Një burim i rëndësishëm të ardhurash është dhënia me qera e antenave të transmetimit, të cilat janë monopol ligjor i stacionit. Megjithatë, në të kaluarën vjelja e këtyre pagesave ka qenë problematike. Borxhi i grumbulluar nga ata që përdorin antenat arriti ALL 194.1 milion (€1.59 milion) në fund të 2006.⁶⁹ Edhe pse ligji e lejon RTSH të presë sinjalin e antenave për ato kompani që nuk kanë bërë pagesat pas paralajmërimeve, transmetuesi publik nuk e ka ndjekur kurrë këtë praktikë, pasi kjo do të niste një sërë veprimesh të zgjatura ligjore.⁷⁰ Në këtë mënyrë, borxhet janë grumbulluar, duke krijuar një sërë precedentësh ku operatorët përdorin shërbimet e RTSH falas. RTSH tashmë ka ndërmarrë nisma ligjore kundër debitorëve kryesorë.⁷¹

⁶³ Burimi: INSTAT dhe EBU, të cituara në OSI/Shqipëria, f. 134.

⁶⁴ Intervistë me Diana Kalaja, Zëvendës Drejtore e Përgjithshme e RTSH, Tiranë, 21 janar 2008.

⁶⁵ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f. 15.

⁶⁶ OSI/ Shqipëria, f. 208–212.

⁶⁷ Ligji nr. 9645, “Për Buxhetin e Shtetit 2007,” i 27 nëntor, 2006, gjendet në http://www.qpz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2006/PDF-2006/135-2006.pdf (parë në 15 korrik 2007).

⁶⁸ Ligji nr. 9836, “Për Buxhetin e Shtetit 2008,” i 26 nëntor, 2007, gjendet në <http://www.minfin.gov.al/downloads/l-9836.doc> (parë në 25 janar 2008).

⁶⁹ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f.16.

⁷⁰ Buletini i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Tremujori i Parë 2007, gjendet në http://www.klsh.org.al/doc/20070507132319_v_departamenti_i_kontrollit_te_institucioneve_financiare,_ndermarrjeve_dhe_shoqerive_publike_nr.1-2007.pdf (parë në 10 korrik 2007).

⁷¹ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f. 16.

3.4 Standartet editoriale

Ashtu si mediat e tjera, RTSH nuk ka një kod të brendshëm etike dhe as ndonjë organ që të mbikqyrë sjelljen sipas standarteve. Në shtator 2006, shoqatat e gazetarëve miratuan një kod etike për të gjitha mediat në Shqipëri. Procesi u lançua nga një OJQ për mediat e bazuar në Tiranë, Instituti Shqiptar i Medias, dhe përfshiu debate me gazetarë, redaktorë, pronarë të medias, menaxherë dhe të tjerë.⁷² Megjithatë, kodi nuk është miratuar “zyrtarisht” nga ndonjë media dhe nuk ka mekanizëm për zbatimin e tij. Në këtë mënyrë, respektimi i tij mbetet në dëshirën e gazetarëve. (*Shih gjithashtu seksionin 4.4*)

Gazetarët e TVSH nuk gëzojnë ndonjë mbrojtje më të madhe në punën e tyre sesa kolegët e tyre në televizione private. Mungesa e kontratave të punës, së bashku me rrogat relativisht të ulëta, nuk përbëjnë nxitje që ata të zhvillojnë pavarësinë editoriale apo të prodhojnë programe cilësore. Stacioni ka përdorur kontrata të posaçme pune dhe metoda pagese arbitrare. Ish-Drejtori i Përgjithshëm Artur Zheji pretendoi se këto kontrata ishin përdorur për të motivuar gazetarët dhe për të përmirësuar profesionalizmin, pasi stacioni po i paguante gazetarët sipas sasisë dhe cilësisë së punës. Por Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) arriti në përfundimin se këto kontrata nuk ishin të ligjshme dhe i kërkoi RTSH të ndreqte gjendjen deri në kontrollin e ardhshëm.⁷³ Sindikatat e RTSH vazhdimisht kanë aluduar se këto kontrata reflektonin preferencat personale të Drejtorit të Përgjithshëm dhe jo motivim profesional.⁷⁴

Ndryshe nga disa stacione televizive private që duket se kanë arritur një shkallë më të lartë pavarësie politike, TVSH ende përballlet me ndërhyrje politike. Ashtu siç e thotë ish-kryetari i Këshillit Drejtues, Kiço Blushi:

Në vend që t'i hiqnin duart nga ky institucion dhe ta ndihmonin pavarësinë që i garanton ligji, nëpërmjet deklaratave të tyre, etiketimit, presionit dhe urdhrave që vijnë nga celularët, të dyja partitë politike dhe liderët e tyre e kanë detyruar ekranin publik të kthehet nga blu në rozë dhe e anasjellta, sipas shijeve të kryetarëve të dy partive kryesore, të cilët e masin ‘cilësinë’ dhe pavarësinë e RTSH nga kohëzgjatja e shfaqjeve të tyre në stacion.⁷⁵

Ndërhyrja politike është veçanërisht e dukshme pas ndërimeve të qeverisë. Pas zgjedhjeve të 2005, koalicioni i partive të djathta, i udhëhequr nga Partia Demokratike që mori pushtetin pas tetë vitesh në opozitë, e ndërroi Këshillin Drejtues, drejtimin dhe një pjesë të stafit të TVSH. Më shumë se 80 punonjës të TVSH u pushuan nga puna, përfshirë këtu 10 gazetarë që njiheshin si me prirje të majta. Stacioni mori në punë njerëz të njohur jo aq për standartet e tyre profesionale sesa për afërsinë me partinë në pushtet dhe qeverinë.⁷⁶

⁷² Autorja e këtij raporti punon në Institutin Shqiptar të Medias.

⁷³ Buletini i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Tremujori i Parë 2007, gjendet në http://www.klsh.org.al/doc/20070507132319_v_departamenti_i_kontrollit_te_institucioneve_financiare,_ndërmarrjeve_dhe_shoqërive_publike_nr.1-2007.pdf (parë në 10 korrik 2007).

⁷⁴ Letër e punonjësve të RTSH, “RTSH ka nevojë për ndryshime urgjente”, *Tema*, 17 shkurt 2006, f. 11.

⁷⁵ Kico Blushi, “Televizioni që ka mbetur peng i partive”, *Standard*, 17 mars 2006, f. 23.

⁷⁶ IREX, “Shqipëria” në *Media Sustainability Index 2006*, f. 5, gjendet në http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2005/MSI05-Albania.pdf (parë në 20 qershor 2007).

4. TRANSMETUESIT PRIVATË

4.1 Rregullimi dhe menaxhimi

Sektori privat i transmetimit në Shqipëri është i gjerë dhe përfshin tre stacione kombëtare televizive, 68 stacione televizive lokale, dy satelitore dhe 44 operatorë televizivë kabllorë.

Megjithatë, mungesa e studimeve profesionale dhe informacionit nga vetë transmetuesit e vështirëson krijimin e një pamjeje të detajuar për sektorin. Burimet e financimit të një tregu kaq të vogël, por të mbipopulluar, mbeten një mister dhe çojnë në pyetje serioze për lidhjen midis burimeve të kapitalit të stacionit nga njëra anë dhe nëpërmjet përmbytjes dhe pavarësisë editoriale nga ana tjetër.

4.2 Pronësia e televizioneve dhe pronësia e ndërthurur

Edhe pse pronësia e huaj nuk është e kufizuar, prania e investuesve të huaj ka ardhur në ulje. Tregu i medias vazhdon të mbetet jotërheqës për investuesit e huaj, pasi operon në një ekonomi të vogël, me infrastrukturë të varfër apo që mungon krejt, si dhe lë vend për konkurrencë të pandershme. Julien Roche, një biznesmen francez që jeton në Shqipëri, shiti 33përqind të aksioneve të tij në stacionin televiziv kombëtar TV Klan ortakëve të tij shqiptarë në 2005.⁷⁷ Në janar 2008, grupi gjerman mediatik Westdeutsche Allgemeine Zeitung (WAZ) shprehu interesin për të investuar në median shqiptare, por për momentin ata po studiojnë ende tregun.⁷⁸

Vetëm Ligji për Transmetimet Numerike përmban masa për të kufizimin e përqendrimit të pronësisë me qëllim që të arrihet pluralizmi i medias.⁷⁹ Një njësi nuk mund të zotërojë më shumë se një licensë për një rrjet tokësor dixhital. Gjithashtu ligji ndalon njësitë me interesa ekonomike apo pozicion në vendimmarrje në një kompani që ka licensë për transmetim dixhital tokësor të kenë interesa ekonomike apo pozita vendimmarrje në një zotëruar tjetër licensë transmetimi dixhitale tokësore.

Megjithatë, një operator rrjeti mund të përfitojë licensë transmetimi për një program televiziv dhe e kundërta. Asnjë operator nuk mund të përfitojë më shumë se 30 përqind të të ardhurave kombëtare nga reklamat televizive. Në përgjithësi, masat ligjore për pronësinë nga ligji i transmetimeve janë të vlefshme edhe për transmetuesit dixhitalë.

4.3 Tregu i reklamave

Mungesa e transparencës së pronësisë së medias dhe të financimit të saj mbeten ende probleme të pazgjidhura dhe polemizuese. Burimet e financimit të medias mbeten të panjohura për shkak të mungesës së studimeve në këtë fushë dhe për shkak të refuzimit të transmetuesve për të

⁷⁷ KKRT, Departamenti Juridik dhe i Licensave, 13 korrik 2007.

⁷⁸ Aida Cama, "Koncerni gjerman i mediave, WAZ, do të hyjë në tregun shqiptar," në *Tema*, 16 janar 2008, f. 2.

⁷⁹ *Ibid.*, Art. 13.

dhënë këtë informacion. Burimi i vetëm zyrtar për këtë treg vazhdon të jetë deklarimi i bilancit vjetor që operatorët dorëzojnë te KKRT. Megjithatë, vetëm një numër i vogël transmetuesish e bëjnë këtë. Në 2006, vetëm 39 transmetues nga më shumë se 100, e dorëzuan bilancin vjetor. Jashtë Tiranës, vetëm 30 përqind të operatorëve i dorëzuan bilancet vjetore. Edhe dy stacionet televizive private kombëtare, TV Klan dhe TV Arbëria, nuk i dorëzuan ato.⁸⁰

Në përgjithësi, operatorët televizivë vazhdojnë të pësojnë humbje. Vetëm pak prej tyre raportojnë fitim. Për shembull, pas një humbjeje prej ALL 33 milionësh (€270,000) në 2003, Top Channel TV pati një fitim prej ALL 4.5 milionësh (€37,000) dhe ALL 28 milionësh (€230,000) në 2004 dhe 2005, respektivisht.⁸¹ Po kështu, pas dy viteve humbjeje, TV Vizion+ pati një fitim prej ALL 7 milionësh (€57,000) në 2005.⁸² Megjithatë, KKRT deklaroi se analiza e deklarimeve financiare gjatë tre viteve të fundit dëshmonte për mospërputhje të rëndësishme, gjë që e bënte rregullatorin të dyshonte se disa stacione i falsifikonin shifrat dhe raportet e tyre.⁸³

Çështja e transparencës së kapitalit në media u bë akoma më e diskutueshme kur Kryeministri Sali Berisha deklaroi në 28 mars 2007 që media në Shqipëri është e lidhur me grupe mafioze, të cilat e përdorin median si një vegël për të demonizuar pjesëtarët dhe veprimet e qeverisë, sidomos në betejën e saj kundër korrupsionit.⁸⁴ Pas kësaj deklarate, pronarët dhe drejtuesit e medias kërkuan fakte dhe emra specifike nga Berisha dhe i kërkuan të dorëzonte në autoritetet e prokurorisë të gjithë informacionin e nevojshëm për të ngritur padi.

Qeveria reagoi duke i përjashtuar pronarët e medias nga pjesëmarrja në tenderët publikë. KKRT ka dhënë të kuptojë vitet e fundit që gjysma e të ardhurave të fituara nga operatorët mediatikë vijnë nga “burime të tjera,” duke iu referuar bizneseve të tjera që drejtohen nga shumica e pronarëve të medias, përfshirë këtu ndërtimin, i cili është biznesi më fitimprurës në Shqipëri për momentin, ose import-eksportin, reklamën apo shërbimet e Internetit.⁸⁵ Qeveria e tanishme më tej propozoi që personave apo kompanive që kishin aksione si në kompani mediatike ashtu dhe në një kompani tjetër t’u ndalohej pjesëmarrja në tendera publikë. Sipas ligjit në fuqi, aksionerët në një stacion radiofonik apo televizivë nuk mund të marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në tendera publikë apo në privatizimin e pronës shtetërore.⁸⁶

Gjithashtu, në 2006 qeveria vendosi të mos jepte më reklama shtetërore dhe njoftime shtetërore për median dhe t’i botonte këto në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.⁸⁷ Shpërndarja e reklamës shtetërore nuk ka qenë kurrë transparente. Përkundrazi, pa masa ligjore të

⁸⁰ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 62.

⁸¹ *Ibid.*, f. 63.

⁸² *Ibid.*

⁸³ *Ibid.*

⁸⁴ Newsletter e Institutit Shqiptar të Medias, gjendet në <http://www.institutemedia.org/pages/news-2007.html#57> (parë në 17 qershor 2007).

⁸⁵ OSI/Albania, pp. 225–228.

⁸⁶ Ligji i Radios dhe Televizionit, paragrafi 7.

⁸⁷ Vendimi për Botimin e Njoftimeve Zyrtare, 29 mars 2006, gjendet në <http://www.keshilliministrave.al/shqip/qeveria/vendimet/buletini%20i%20njoftimeve.asp> (parë në 29 korrik 2007) (më tej Vendimi i Këshillit të Ministrave për Buletinin.)

detajuara për shpërndarjen e reklamës shtetërore, qeveria shkëmbente reklamën me pasqyrim të favorshëm.⁸⁸ Nuk ka të dhëna të sakta për shpenzimet e përgjithshme të kompanive apo organeve shtetërore për reklamën. Burimi i vetëm publik për një informacion të tillë ishte një studim eksperimental i kryer nga rregullatori. Studimi tregoi se kompania shtetërore e energjisë KESH kishte shpenzuar US\$560,000 për reklamën në 2004, e cila ishte një shumë tre herë më e madhe se ajo e shpenzuar para tre vjetësh. I njëjti studim tregoi se Albtelekom, kompania shtetërore e telefonisë fikse, kishte shpenzuar €320,000 për reklamën në 2004.⁸⁹ Këto ishin të vetmet kompani të mëdha që bëjnë reklamë që dhanë informacion për shpenzimet e tyre.

Vendimi i qeverisë për të kaluar reklamën shtetërore në buletin zyrtar ishte një hap i rëndësishëm për të zvogëluar varësinë e medias nga shteti. “Ky është një akt i rëndësishëm dhe pozitiv, qoftë edhe në aspektin moral, edhe pse ekzistojnë kontradikta dhe akti nuk zgjidh përfundimisht problemin e tjetërsimit të medias sonë [nga publiku].”⁹⁰ Dallimi, për shembull, midis reklamës shtetërore dhe njoftimeve shtetërore nuk është tërësisht i qartë dhe krijon hapësirë për interpretim. Sipas vendimit të qeverisë, reklamat për kompanitë shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse të krijuara dhe të mbështetura nga shteti nuk klasifikohen si njoftime publike.⁹¹ Kjo mund të lërë hapësirë që njësitë shtetërore të vazhdojnë të çojnë reklamat e tyre në media. Pa transparencë, është e vështirë të vlerësohet ndikimi i vendimit të qeverisë në sektorin e televizionit.

Një editorialist i mirënjohur shqiptar shkroi se “shumica e gazetave të përditshme në vend janë në koma, ndërsa audienca e stacioneve televizive është polarizuar, duke i nxjerrë jashtë tregu shumicën e stacioneve periferike”.⁹² Të gjitha të dhënat për tregun e reklamës janë spekulim i pastër. Përpyekja e vetëm e vlefshme në këtë drejtim u bë nga KKRT, e cila monitoroi reklamën në dhjetë stacione televizive në prill dhe maj 2005. Sipas këtij monitorimi, sasia e reklamës dhe teleshitjeve përbënte rreth 10 përqind të gjithë kohës së transmetimit.⁹³ Ligji i detyron stacionet televizive të mos rezervojnë më shumë se 15 përqind të kohës së transmetimit të tyre ditor, ose më shumë se 12 minuta në orë, për reklamën. Ky rregull në përgjithësi u respektua nga operatorët televizivë. Përrjashtim përbënte TV Klan, i cili transmetoi reklama gjatë 22 përqind të kohës së transmetimit.⁹⁴

Studimi tregonte se vlera e përafërt e tregut shqiptar të reklamës televizive shkonte rreth 21 milionë.⁹⁵ Duke e krahasuar këtë vlerësim me deklaratimet financiare vjetore të dorëzuara nga stacionet televizive, monitorimi arriti në përfundimin se operatorët televizivë raporttonin

⁸⁸ OSI/Shqipëria, f. 225–228.

⁸⁹ KKRT, Vlerësim i Të Ardhurave nga Reklama nga Monitorimi, prill–maj 2005, f. 5 (më tej, Studimi i KKRT për Reklamat).

⁹⁰ “Përpyekja”, Intervistë me Fatos Lubonjën, *Standard*, 27 maj 2006, f. 35.

⁹¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave për Buletinin.

⁹² Mero Baze, “Përpyekja e ‘regjimit mediatik’ drejt konkurrencës”, *Tema*, f. 1, 23 prill 2006.

⁹³ Studimi i KKRT për Reklamat, f. 2.

⁹⁴ Studimi i KKRT për Reklamat, f. 3.

⁹⁵ *Ibid.*, f. 5.

vetëm midis 17 dhe 22 përqind të të ardhurave nga reklama.⁹⁶ Ky përfundim hodhi dyshime për evazion fiskal.⁹⁷ Autorët e këtij studimi paralajmëruan se duke pasur parasysh mungesën e tyre të përvojës në vlerësimin e tregut të reklamës, shifrat e tyre duheshin marrë me rezervë.⁹⁸ Por policia tatimore e mori studimin seriozisht dhe vendosi një gjobë prej €12 milionësh Top Channel TV në korrik 2007. Monitorimi i KKRT u përdor si bazë për të llogaritur evazionin fiskal për reklamat për vitet 2002–2005. Duke u nisur nga ky studim, u supozua se Top Channel TV kishte raportuar vetëm 23 përqind të të ardhurave të tij në ato vite.⁹⁹

Kjo gjobë u vendos pas kontrolleve të përsëritura të policisë tatimore ndaj Top Channel TV gjatë 2007, kur stacioni mori një qëndrim mjaft kritik ndaj qeverisë. Pronari tha se ai e kishte pritur të vendosej një gjobë, por niveli i gjobës ishte krejtësisht i paarsyeshëm dhe kishte për qëllim të heshte një zë kritik.¹⁰⁰ Lëvizja e policisë tatimore shtyu komunitetin e medias të dilte me një deklaratë të përbashkët në mbështetje të Top Channel TV.¹⁰¹ Komisioni Parlamentar i Medias dhe Prokuroria e Përgjithshme gjithashtu nisën një hetim. Pas këtij presioni, u duk se qeveria do e merrte sërish nën shqyrtim gjobën. Stacioni ende nuk e ka paguar gjobën dhe po negocion me autoritetet. Top Channel TV është një shembull i qartë se si mund të abuzohen apo keqpërdoren mungesa e të dhënave dhe monitorimeve dhe studimeve sistematike për tregun e reklamës, së bashku me mungesën e transparencës nga ana e kompanive që bëjnë reklamë, medias dhe qeverisë.

4.4 Standartet dhe pavarësia editoriale

Në 2005, Instituti Shqiptar i Medias nisi një rishikim të Kodit të Etikës për gazetarët, i cili ishte hartuar në 1996. Instituti e ndërmori këtë punë si një reagim ndaj zbatimit joefikas të Kodit dhe i nisur nga nevoja për ta përshtatur Kodin me ndryshimet që kanë ndikuar te media në dekadën e kaluar. Një arsye tjetër ishte qëllimi i Institutit për të filluar një sistem efikas vetë-rregullimi në media. Amendamentet ligjore që kanë për qëllim të dekriminalizojnë shpifjen dhe fyerjen po diskutohen në Parlament dhe ka të ngjarë të miratohen në të ardhmen e afërt.

Në procesin e rishikimit, instituti u përpoq të përfshijë të tërë palët kryesore të interesuara, përfshirë pronarët, drejtuesit, kryeredaktorët, gazetarët, aktivistët e shoqërisë civile, deputetët, juristët e medias, etj. Instituti e kompletoi Kodin e ri të Etikës dhe një statut të një organi vetë-rregullues.

⁹⁶ *Ibid.*, f. 6.

⁹⁷ *Ibid.*, f. 7.

⁹⁸ Metodologjia e studimit bazohej në një formulë sipas së cilës vlera e të ardhurave nga reklama llogaritej duke shumëzuar kohën e reklamës me tarifën fikse që raportoheshin nga stacionet televizive. Ajo nuk merrte parasysh dhe nuk mund të llogariste zbritjet dhe negociatat për klientët apo kohëzgjatjen e kontratës së një stacioni televiziv me një klient. (f. 1).

⁹⁹ Njoftim për Shtyp i Policisë Tatimore, gjendet në <http://www.tatime.gov.al/?fq=info&metod=shfaqart&artID=362> (parë në 25 korrik 2007).

¹⁰⁰ Dritan Hoxha, Koment në Tryezën e Rrumbullakët të Top Channel TV, Tiranë, 14 korrik 2007.

¹⁰¹ Deklarata gjendet në [http://www.institutemedia.org/documenta/PRESS_DECLARATION_dt\[1\].13_korrik.doc](http://www.institutemedia.org/documenta/PRESS_DECLARATION_dt[1].13_korrik.doc) (parë në 20 korrik 2007).

Në përgjithësi, gazetarët, pronarët dhe menaxherët ranë dakord në parim për nevojën për të vetërregulluar këtë sektor. Mbetet për t'u parë nëse ata do të bashkohen për ta realizuar këtë gjë.

Me përjashtim të rregullave të përgjithshme editoriale të vendosura nga kryeredaktorët. Nuk ka kode të brendshme etike në stacionet televizive.¹⁰² KKRT vazhdimisht ka theksuar në raportet e saj se mediat duhet të kenë kodin e vet të etikës.¹⁰³ Përveç kësaj, gazetaria cilësore është vështirë të arrihet në rrethana kur vetë gazetarët shpesh privohen nga të drejtat e tyre. Shumica dërrmuese e gazetarëve punojnë pa kontrata për shkak të zbatimit të dobët të Kodit të Punës dhe mungesës së mbikqyrjes së rregullt të zbatimit të tij. Një hap pozitiv në këtë aspekt ishte krijimi në 2005 i sindikatës së gazetarëve me mbështetjen e IREX. Unioni ka krijuar degë në qytetet kryesore dhe ka negociuar kushte më të mira pune për gazetarët me Ministrinë e Punës. Dy palët firmosën një memorandum që do të krijonte mundësinë e krijimit të një marrëveshjeje kolektive në këtë sektor.

Megjithatë, si unioni, ashtu edhe komuniteti i medias janë të ndërgjegjshëm që ky proces do të zgjasë njëfarë kohe, për shkak të përhapjes së problemit. Në 2005, rreth 95 përqind e gazetarëve në Shqipëri punonin pa kontrata apo sigurime shoqërore.¹⁰⁴ Shoqatat e tjera të gazetarëve nuk kanë dhënë ndonjë ndihmë në këtë fushatë dhe duket se ekzistojnë vetëm në letër. Kryetari i njëres prej këtyre organizatave tha:

Edhe pse kemi 15 vjet liri shtypi në Shqipëri, ka vetëm pak raste kur kolegët e një media ngrenë zërin apo protestojnë kundër fatit të kolegëve të tjerë të cilët pushohen, censurohen apo kërcënohen pa të drejtë. Kjo është një temë vetëm për kafenetë ku mblidhen gazetarët dhe nuk hapet kurrë në publik, duke krijuar një gjendje ku askush nuk flet për një dukuri që i prek të gjithë.¹⁰⁵

Kjo gjendje i lë gazetarët të pambrojtur kundrejt dëshirave dhe tekave të pronarëve. “Ata janë krejtësisht të pambrojtur kur përballen me vendimet arbitrare të pronarëve, të cilët mund ta pushojnë stafin nga puna pa asnjë arsye.”¹⁰⁶ Kjo situatë nuk ka ndryshuar në dy vitet e fundit dhe vështirë se do të përmirësohet pa hedhur dritë mbi pronësinë e medias dhe financimin e saj. Numri i madh i gazetave dhe stacioneve televizive në Shqipëri ia detyron ekzistencën kryesisht financimit nga bizneset paralele dhe zbatimit të dobët të ligjit. “Nga pikëpamja profesionale, ky financim paralel i lë shumë media të pambrojtura ndaj presionit apo censurës së bizneseve që i mbështesin ato, në shkallë të ndryshme.”¹⁰⁷

¹⁰² OSI/Shqipëria, f. 238–239.

¹⁰³ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 55.

¹⁰⁴ Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, “Mbrojtja në punë dhe sigurimi social i punonjësve të medias, një domosdoshmëri për shtypin e lirë”, f. 6.

¹⁰⁵ Intervistë me Armand Shkullakun, “Media, transparence për lajmet brenda saj”, *Shqip*, 10 maj 2006, f. 12.

¹⁰⁶ IREX, Media Sustainability Index 2005 – Shqipëria, IREX, Washington DC, 2006, f. 14, gjendet në faqen e Internetit të IREX te http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2005.asp (parë në 20 korrik 2007) (më tej, IREX, *MSI 2005 – Shqipëria*).

¹⁰⁷ IREX, *MSI 2005 – Shqipëria*, f.12

4.5 Transmetuesit rajonalë dhe lokalë

Për momentin ka 68 stacione televizive lokale, nga të cilët 20 operojnë në Tiranë. Shumica e reklamës shpenzohet në stacionet televizive të Tiranës. Këto kanë një performancë ekonomike dhe programim më të mirë se stacionet lokale, të cilat e kanë të vështirë të mbijetojnë dhe të prodhojnë programe cilësore. “Media e përqendruar në Ultësirën Perëndimore ka mundësi më të mëdha për të përfituar nga një treg më i pasur reklame, gjë që nuk vlen për mediat e vendosura në zona më të largëta.”¹⁰⁸

Për shkak të vështirësive ekonomike, stacionet televizive lokale në vend e kanë të vështirë të përshtaten me zhvillimin teknologjik. Ndërsa shumica e stacioneve televizive në Tiranë zotërojnë pajisje të kohëve të fundit, stacionet lokale ende punojnë me pajisje të vjetra, gjë që ndikon në cilësinë e produktit të tyre.

5. PROGRAMACIONI

5.1 Programet

Pa monitorime të pavarura, nuk ekzistojnë statistika për programet vjetore sipas llojit, as për transmetuesin publik e as për ata privatë. Monitorimi i fundit, i cili u krye nga KKRT gjatë një muaji në 2003 e largët, mbulonte programacionin e stacioneve kryesore. Edhe pse stacionet private janë të detyruara me ligj të dorëzojnë programacionin vjetor te KKRT, deri tani nuk kanë arritur të respektojnë këtë kërkesë apo të shpjegojnë se përse nuk e bëjnë këtë gjë. Rregullatori nuk ka marrë ndonjë masë ndaj tyre.

Të vetmet të dhëna vijnë nga TVSH. Rreth 70 përqind të kohës së transmetimit të TVSH nga prilli në nëntor 2006 nuk ishin programe të prodhuara vetë. Kuadri i programacionit të stacionit nuk ka mundur të shmangë rutinën dhe monotoninë, gjë që ka ndikuar në pozicionin e tij në treg.¹⁰⁹ Me ndryshimin e menaxhimit në fund të 2006, nisën të transmetoheshin programe të një cilësie më të lartë. Me këto ndryshime, përqindja e programeve të prodhuara vetë pritet të arrijë deri në 70 përqind të kohës totale të transmetimit të stacionit në 2007.¹¹⁰ Këshilli Drejtues i RTSH gjithashtu premtoi se programe të tjera po rishikohen dhe programe të reja që pasqyrojnë tema si çështje sociale, balancën gjinore, kulturën dhe shëndetësinë do të lançohen.¹¹¹

Megjithatë, ndryshimet në kuadrin e programacionit janë përpjekje që përmbushin vetëm kërkesat minimale të transmetuesit publik dhe nuk i japin shtysë standarteve të transmetuesit publik. Raporti vjetor i stacionit pretendonte për arritje të tilla që koha e transmetimit ishte rritur nga 17 orë në 24 orë në ditë, rikthimin e programeve sportive javore, hapjen e një studioje

¹⁰⁸ IREX, *MSI 2006 – Shqipëria*, f. 5.

¹⁰⁹ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f. 3.

¹¹⁰ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f. 5.

¹¹¹ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f.5.

të re transmetimi, përdorimin e studios lëvizëse në ditën e zgjedhjeve, etj.¹¹² Drejtoresha aktuale e stacionit, Mirela Oktrova, shkruante: “Ekzistenca e radios dhe televizionit publik nuk mund të justifikohet as me programet e zbavitjes e as me transmetimin falas të programeve të EBU, e as me organizimin e festivalit dhe bujën e pjesëmarrjes në Eurovizion.”¹¹³

Në një aspekt më pozitiv, TVSH organizoi debate televizive me kandidatët për bashki gjatë zgjedhjeve të 2007, duke i dhënë mundësinë publikut të bënte një zgjedhje më të informuar. Nga ana tjetër, TVSH nuk ishte në gjendje të transmetonte një ngjarje të rëndësishme si Kupa Botërore e futbollit në 2006, pasi të drejtat e transmetimit u blenë nga DigitAlb. Në atë kohë TVSH tha se nuk mund t’i përballonte të drejtat, por KKRT u përgjigj se stacioni mund të kishte kërkuar ndihmë nga shteti.¹¹⁴ Në mënyrë sarkastike ata shtuan se menaxhimi i TVSH nuk këmbënguli shumë pasi po negocionte të drejtat e “Kafazit të Artë,” një programi të prodhuar në vend, por që është kopje e formatit të programit të realitetit “Big Brother.”¹¹⁵

Megjithë mungesën e të dhënave të qarta për programet, mund të thuhet me siguri se shumica e stacioneve të rëndësishme si TV Klan, Top Channel, Vizion+, TV Koha dhe disa kanale lajmesh si News24 apo Alsat kanë fituar një publik pak a shumë besnik. Ata prodhojnë lajme me standarte përgjithësisht të kënaqshme si dhe programe të ndryshme informacioni dhe zbavitjeje. Informacioni dhe lajmet janë kthyer në përparësi si për median e shkruar, ashtu edhe për atë elektronike, sipas vëzhguesve të ndryshëm.¹¹⁶ Përjashtim përbënte stacioni privat kombëtar TVA, i cili pas disa ndryshimeve në pronësi në 2006, mezi arrinte të përmbushte detyrimet e tij si kanal kombëtar. Ky stacion nuk transmetoi fare edicione lajmesh në mars dhe prill 2006.¹¹⁷ Meqë stacioni nuk mundte të përmbushte për shumicën e 2006 kërkesat e programacionit që i impononte kontrata e licensës, KKRT vendosi të reduktonte me një vit licensën e TVA dhe ta tërhiqte atë më pas në tetor 2007. Stacioni e apeloj këtë vendim dhe të dyja palët e çuan çështjen në gjykatë.¹¹⁸

Disa nga lajmet dhe debatet për tema të rëndësishme, shpesh politike, mendohet se kanë një publik të qëndrueshëm dhe janë kthyer në emblema të stacioneve televizive që i transmetojnë ato. Përveç buletineve të lajmeve, disa nga programet më të njohura janë “Opinion” në TV Klan, “Shqip” në Top Channel, “Logos” në Vizion+ dhe “60 minuta” në TV Koha. Këto janë programe javore që kanë të bëjnë me intervista apo debate për një temë të caktuar. Një tjetër program mjaft i njohur është “Fiks fare,” një revistë satirike e përditshme që bazohet në metoda investigative. Ka dhe disa programe zbavitjeje dhe lojëra që janë mjaft të njohura. Këtu përfshihet “Portokalli” dhe “Top Show” në Top Channel, “Kutia e fundit” në TV Klan dhe “Bypass” në Vizion+. Stacionet televizive kanë një prirje në rritje të përqendrohen në programe të një natyre më sociale, duke u përpjekur të pasqyrojnë më shumë kronika nga jeta e përditshme dhe me interes njerëzor. Këto programe përfshijnë “Jetë në kërkim” në News24 TV, “Njerëz të humbur,” “Femra” dhe “S.O.S.” në Vizion+.

¹¹² Raporti Vjetor i RTSH 2006, f.4.

¹¹³ Mirela Oktrova, “Lehja kundër demokracisë dhe interesave të publikut”, *Shekulli*, 4 shtator 2006, f. 23.

¹¹⁴ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 52.

¹¹⁵ Ibid.

¹¹⁶ IREX, *MSI 2006 – Shqipëria*, f. 9.

¹¹⁷ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 54.

¹¹⁸ Vendimi për TVA në Raportin Vjetor të KKRT 2006, f. 25.

5.2 Rregullat e përgjithshme për lajmet

Disa rregulla në Ligjin për Radion dhe Televizionin përqendrohen te programimi i përmbytjes dhe vlejnjë si për transmetuesit publikë, ashtu edhe për ata privatë. Ato kanë të bëjnë me pavarësinë editoriale, censurën, të drejtën e informacionit dhe të drejta dhe liri të tjera njerëzore.¹¹⁹ Edhe pse parimet themelore të informacionit të paanshëm dhe të saktë janë të garantuara me ligj, nuk ekzistojnë instrumente apo organe që të monitorojnë zbatimin e tyre. KKRT monitoron edicionet kryesore të lajmeve të stacioneve kombëtare publike dhe private, por kjo përpjekje konsiston vetëm në matje sasiore të përqindjes që i kushtohet pasqyrimin të partive dhe figurave politike.

Stacionet televizive kanë bërë përparim të ndjeshëm në përkufizimin e vetvetes nëpërmjet edicioneve të lajmeve, të cilat kanë shënuar përmirësimin më të madh në programacionin të të gjitha stacionet televizive.¹²⁰ Megjithatë, informacioni nuk është as i paanshëm dhe as i drejtë. Pothuajse nuk ekziston ndonjë media që të mos ketë interesa të fshehura ekonomike apo politike dhe për pasojë, standartet profesionale aplikohen për aq kohë sa ua lejojnë këto interesa. Axhenda e lajmeve është shumë pranë axhendës së qeverisë apo politikës në përgjithësi, ose pranë menaxhimit të televizioneve.¹²¹ Edicionet e lajmeve zgjedhin kronika që u shkojnë për shtat interesave të operatorit dhe jo interesit publik.¹²²

Edhe Kodi Zgjedhor imponon kërkesa për saktësi, korrektësi dhe balancë për të gjitha stacionet televizive.¹²³ Transmetuesi i shërbimit publik ka përgjegjësi shtesë, si dhënia e kohës falas për të gjitha partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje. Testi më i fundit për respektimin e këtyre rregullave ishin zgjedhjet lokale në shkurt 2007. Stacionet televizive kryesore e kaluan këtë test me sukses. TVSH i kushtoi 28 përqind të lajmeve Partisë Demokratike dhe 29 përqind Partisë Socialiste. Një pasqyrim i ngjashëm u gjend edhe për stacione të tjera të mëdha si Vizion+, News24, dhe TVA. Përfundimisht përbënte TV Klan, i cili i kushtoi më shumë kohë qeverisë se çdo stacion tjetër. Përfaqësuesit e TV Klan pretenduan se ata thjesht po pasqyronin punën e zyrtarëve të shtetit. Megjithatë, këta zyrtarë ishin pasqyruar teksa bënin fushatë zgjedhore. Edhe pse këto fushata u konsideruan të balancuara dhe të drejta në aspektin e pasqyrimin të partive politike, gjatë periudhës parazgjedhore të gjitha stacionet televizive kishin favorizuar një parti më shumë se të tjerat.¹²⁴

¹¹⁹ OSI/Shqipëria, f. 234

¹²⁰ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 47.

¹²¹ Monitorimi u krye në kuadrin e “Monitorimi i Lajmeve të Mbrëmjes në TV – monitorim dhe analizë e edicioneve të lajmeve në TV në 10 vende të Europës Juglindore”, botuar në Media Plan Institute, *Treguesi i Interesit Publik*, Sarajevo, 2007.

¹²² Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 54.

¹²³ Kodi Zgjedhor, neni 136, neni 140, gjendet në <http://www.osce.org/item/14076.html?html=1> (parë në 10 korrik 2007).

¹²⁴ Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet e 18 shkurt 2007, gjendet në <http://www.osce.org/item/24859.html?html=1> (parë në 12 korrik 2007).

5.3 Udhëzimet e përgjithshme për prodhimin e programeve

Ligji për Radion dhe Televizionin vendos disa detyrime të përgjithshme për të gjitha stacionet televizive. Këto kanë të bëjnë kryesisht me dinjitetin njerëzor, respektin për ligjin dhe të drejtat e njeriut.¹²⁵

Megjithatë, këto masa janë mjaft të vakëta dhe të përgjithshme dhe nuk janë shndërruar në rregulla më të detajuara nga KKRT. Këto parime të përgjithshme në përgjithësi janë respektuar. Të vetmet probleme kishin të bënin me pornografinë, e cila ndalohet krejtësisht për t'u transmetuar. Në stacionet tokësore analoge nuk transmetohen programe me përmbajtje pornografike. Megjithatë, DigitAlb transmeton pornografi gjithë kohën në një kanal në formë të kriptuar, si dhe dy programe pornografike në mesnatë.

5.4 Kuotat

Nuk ekzistojnë kuota të posaçme për përfaqësim gjuhësor apo të grupeve të minoriteteve. Stacioni i transmetimit publik si dhe disa kanale private ndonjëherë transmetojnë programe për minoritetet etnike. Në vitet e fundit, Instituti Shqiptar i Medias është angazhuar në koordinimin e projekteve të prodhimit të programeve radiofonike dhe televizive për pakicat etnike dhe gjuhësore në vend si dhe për artikuj për këto tema të botuara në median e shkruar.

Mediat që fokusohen në temat e pakicave luftojnë për mbijetesë. Për shembull, Radio Prespa, e themeluar në 2003 në zonën e kufirit me Republikën e Maqedonisë dhe që transmeton maqedonisht, nuk funksionon rregullisht për shkak të pengesave financiare. Stacionet radiofonike për pakicën greke në jug të vendit gjenden në një situatë të ngjashme. Të gjitha këto media janë nisma individuale; shteti nuk jep ndihma për median e minoriteteve. Megjithatë, nuk ekzistojnë pengesa ligjore për dhënie të licensave të transmetimit për radiot apo televizionet e minoriteteve. Në fakt, KKRT dha një licensë për radio dhe televizion radio/TV Armonia, një projekt për pakicën greke që është edhe minoriteti më i madh etnik në vend. Megjithatë, stacioni nuk ka fuqi financiare dhe ka vështirësi. Për momentin ata nuk transmetojnë.¹²⁶

Kuotat e vetme në lidhje me përmbajtjen që imponon ligji për ata që kanë licensë lokale është që të transmetojnë programe jokomerciale dhe programe lokale informacioni për të paktën 15 përqind të programacionit javor. Ligji nuk e specifikon termin “jokomercial”. Sipas ndryshimeve të 2003, ata që kanë licensë kombëtare duhet t'i kushtojnë të paktën 15 përqind të kohës së transmetimit programeve të prodhuara vetë dhe të paktën 30 përqind programeve të prodhuara në Shqipëri. Stacionet televizive në përgjithësi i përmbushin këto kuota.¹²⁷ Ligji gjithashtu vendos kuota për reklamën, duke mos i lejuar stacionet televizive të transmetojnë reklama për më shumë se 15 përqind të kohës ditore të transmetimit ose më shumë se 12 minuta për orë.

¹²⁵ OSI/Shqipëria, f. 235–236.

¹²⁶ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 25.

¹²⁷ Raporti Vjetor i KKRT 2006, f. 47.

Edhe pse Shqipëria, si vend që nuk është anëtar i BE, nuk është e detyruar të përmbushë legjislacionin europian, shumë nga këto kuota lindin nga Konventa Europiane për Televizionin Ndërkufitar (KETN) dhe Protokollin e saj Shtesë, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar në 1999. Nga ana tjetër, legjislacioni shqiptar nuk u kërkon transmetuesve t'i kushtojnë shumicën e kohës së transmetimit veprave europiane. Ligji për dixhitalizimin thotë se stacionet televizive, në mënyrë progresive, duhet të përmbushin detyrimin e transmetimit të programeve europiane në 50 përqind të kohës së transmetimit.

5.5 Detyrimet për transmetuesin publik

Përveç rregullave të përgjithshme për prodhimin, Ligji për Radion dhe Televizionin i detyron si transmetuesit publikë, ashtu dhe ata privatë të transmetojnë programe falas. Kjo përfshin programe me interes të lartë për publikun e gjerë si lajmërimet për shëndetin, rendin publik apo emergjencat kombëtare. Gjithashtu ligji i kërkon RTSH të transmetojë falas shërbimet fetare të mbajtura gjatë festave fetare zyrtare si dhe seancat e parlamentit. Ligji për Radion dhe Televizionin vendos detyrime shtesë për RTSH. Programet e tij duhet të jenë të një cilësie të lartë, të reflektojnë larminë e jetës shqiptare dhe t'i shërbejnë të gjitha grupeve shoqërore, përfshirë pakicat kombëtare.

Pasqyrimi i lajmeve nga vendi dhe nga jashtë duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i paanshëm. RTSH-së i ndalohet transmetimi i propagandës politike dhe fetare. Megjithë këto detyrime, transmetuesi i shërbimit publik mbetet ende larg përmbushjes së misionit të tij publik. “Është paradoksale të shohësh se si interesi publik është i pari që lihet pas dore nga një televizion i quajtur ‘publik.’ Edicionet e lajmeve fillojnë me lajme për aktivitetet e qeverisë dhe partive politike, duke lënë pas dore problemet që shqetësojnë qytetarët.”¹²⁸ Stacioni pretendon se ka bërë progres të rëndësishëm dhe se mungesa e konkurrencës që pretendohet se ka është një gënjeshtëri e hapur nga rivalët privatë.¹²⁹ Por mendimi i përgjithshëm është se stacionet private mbizotërojnë. “Televizionet komerciale po e vrasin televizionin publik dhe po thithin të gjithë audiencën ashtu si supermarketet po vrasin dyqanet e vogla dhe kioskat e komunizmit duke thithur të gjithë blerësit.”¹³⁰

5.6 Detyrimet për transmetuesit privatë

Nuk ka detyrime të hollësishme programacioni për transmetuesit privatë. Masat e vetme ligjore kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e transmetimit dhe periodicitetin e edicionit të lajmeve. Stacionet televizive kombëtare duhet të transmetojnë të paktën gjashtë orë në ditë, kurse stacionet lokale të paktën katër orë në ditë. Stacionet televizive kombëtare duhet të transmetojnë programe origjinale lajmesh çdo ditë. Stacionet televizive private janë të detyruara të transmetojnë mesazhe dhe informacion të një interesi të madh publik falas, sipas rregulloreve të hartuara nga KKRT, ose me kërkesën e organeve lokale të qeverisë. Informacione të tilla zakonisht përfshijnë komunikatat e shkurtra me interes të posaçëm për publikun, sidomos

¹²⁸ IREX, *MSI 2006 – Shqipëria*, f. 10.

¹²⁹ Raporti Vjetor i RTSH 2006, f. 3.

¹³⁰ IREX, *MSI 2006 – Shqipëria*, f. 6.

në situata emergjence, si fatkeqësi natyrore, ose në tema si shëndeti dhe siguria, si dhe rendi publik. Në përgjithësi, nuk ka patur probleme me respektimin e këtij detyrimi.

6. PËRFUNDIMET

Televizioni, ende media me ndikim më të madh në Shqipëri, ka kaluar një erë ndryshimesh. Janë bërë ndryshime ligjore të rëndësishme, edhe pse të diskutueshme, duke ndryshuar përbërjen e autoriteteve rregullatorë. Struktura, e bazuar në një formulë përfaqësimi të balancuar politik, u shndërrua në një formulë që përfshinte shoqërinë civile, akademikët dhe profesionistët. Këto lëvizje zyrtarisht kishin për qëllim të ulnin ndikimin politik të rregullatorit, por disa nga veprimet e fundit të rregullatorit u konsideruan si të motivuara politikisht. Për më tepër, rregullatori pati probleme të krijonte anëtarësimin e plotë, një tregues që mekanizmi i emërimit nuk funksionon pa probleme.

Së shpejti rregullatori do të përballet me një test të vështirë: shpërndarjen e licensave dixhitale. Ashtu si ligje të tjera të miratuara gjatë tre viteve të fundit, Ligji për Transmetimet Numerike u përgatit nga qeveria pa u këshilluar me palët e interesuara, gjë që hodhi mjaft dyshime për qëllimet e qeverisë dhe pasojat e këtij ligji në transmetime. Zbatimi i këtij ligji ngrë pikëpyetje të rëndësishme për të ardhmen e DigitAlb, operatorit të platformës dixhitale, i cili pas tre vjetësh veprimtarie është kthyer në një lojtar të fuqishëm me një bazë të rëndësishme klientësh. Autoriteti dhe pavarësia e KKRT në procesin e licensimit, si dhe qëndrimi i transmetuesit të shërbimit publik në këtë proces, do të jenë mjaft të rëndësishme.

RTSH përballet me detyrën e vështirë e sfidës ndaj rritjes së DigitAlb, që nuk do të jetë e lehtë, sidomos pas performancës jo të mirë ekonomike në vitet e fundit, financimi në ulje nga shteti dhe reformës së papërfunduar. Popullariteti i RTSH nuk është përmirësuar. Menaxhimi jo i mirë dhe prapambetja në krahasim me transmetuesit privatë, së bashku me mendimin e përgjithshëm që RTSH kontrollohet politikisht, janë ndër problemet kryesore të transmetuesit. Stacioni mbetet ende larg përmbushjes së misionit të tij publik. Shpresohet që menaxhimi i ri i stacionit do të hartojë një strategji koherente dhe të fillojë një reformë të qëndrueshme. Megjithatë, reforma e RTSH do të jetë e dhimbshme dhe si e tillë, stacioni do të ketë nevojë për ndihmesë të rëndësishme në arritjen e misionit të tij.

Programet profesionale dhe cilësore po vijnë në rritje. Megjithatë, tregu mbetet i mbipopulluar dhe megjithë zhurmën për burimet e financimit të medias, nuk janë marrë masa konkrete në këtë drejtim. Transparenca e burimeve të kapitalit të medias nevojiten medoemos në një vend ku gazetarët, të cilët nuk kanë kontrata pune, shpesh kanë frikë të rrezikojnë e të provokojnë pronarët duke shkruar në mënyrë të pavarur. Organizatat për median kanë bërë përpjekje të shumta për të rritur ndërgjegjësimin për kodet e etikës të gazetarët, por vetë-rregullimi efikas ende nuk ka nisur. Mangësia e studimeve të tregut ose të të dhënave të tjera i pengon mjaft vlerësimet për kushtet e medias shqiptare.

ANEKS1. LEGJISLACIONI I PËRMENDUR NË RAPORT.

Fletorja Zyrtare është gazeta zyrtare e Shqipërisë.

Direktiva 97/36/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit në 30 qershor 1997, e cila amendon Direktivën e Këshillit 89/552/EEC për koordinimin e disa masave të hartuara me ligj, rregullim apo veprim administrativ në shtetet anëtare në lidhje me ndërmarrjen e veprimtarive të transmetimit televiziv, *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian*, L 202, 30 korrik 1997.

Direktiva 2007/65/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit në 11 dhjetor 2007, e cila amendon Direktivën e Këshillit 89/552/EEC për koordinimin disa masave të hartuara me ligj, rregullim apo veprim administrativ në shtetet anëtare në lidhje me ndërmarrjen e veprimtarive të transmetimit televiziv, *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian*, L 332/27, 18 dhjetor 2007.

Kodi Zgjedhor, neni. 136, neni. 140, gjendet në <http://ëëë.osce.org/item/14076.html?html=1> (parë në 10 korrik 2007).

Ligji për Transmetimet Numerike, Ligji nr. 9742 në 28 maj 2007 për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë, *Fletorja Zyrtare* 20 tetor 1998; amenduar me ligjin nr. 8657, datë 31.07.2000; ligjin nr.8794, datë 10.05.2001, ligjin nr.9016, datë 20.02.2003 dhe ligjin nr.9124, datë 29.07.2003, si dhe Ligji nr. 9677 i 13 janarit 2007.

Ligji nr. 9531 i cili ndryshon Ligjin për Radion dhe Televizionin me kapitullin “Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat”, 11 maj 2006, *Fletorja Zyrtare*, 65, 2006.

Ligji nr. 9645, “Për Buxhetin e Shtetit 2007”, i 27 nëntorit, 2006.

Ligji nr. 9836, “Për Buxhetin e Shtetit 2008”, i 26 nëntorit, 2007.

ANEKS 2. BIBLIOGRAFIA

Në anglisht

IREX, Media Sustainability Index 2005 – Albania, IREX, Washington D.C., 2006.

IREX, Media Sustainability Index 2006 – Albania, IREX, Washington D.C., 2007.

Në shqip

KKRT, *Vlerësim i të Ardhurave të Reklamave nga Monitorimi*, prill–maj 2005.

KKRT, *Raporti Vjetor 2006 në Kuvendin e Shqipërisë*.

RTSH, *Raporti Vjetor për Veprimtarinë e RTSH 2006*.

Buletini i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Tremujori i Parë, 2007.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, “Mbrotja në punë dhe sigurimi social i punonjësve të medias, një domosdoshmëri për shtypin e lirë.”

